



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 714 Akti

Nr. 708 Vendimi  
Tiranë, më 26.10.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 24.10.2023, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Mustafa Turku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i pranishëm në seancë dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, e nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr.84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr.44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit administrativ, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Mustafa Turku është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është mbledhur në datën 15.12.2020 për hedhjen e shortit sipas listës së subjekteve të

rivlerësimit, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Mustafa Turku do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2 me përbërjen si më lart.

2. Në datën 15.1.2021, trupi gjykues ka zgjedhur kryesuese komisioneren Firdes Shuli, gjithashtu anëtarët kanë deklaruar lidhur me konfliktin e interesit. Është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

3. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjatë hetimit administrativ është komunikuar nëpërmjet postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, praktikë e cila është administruar në dosjen e hetimit administrativ.

4. Në datën 20.9.2023, trupi gjykues, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Mustafa Turku, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, si dhe ta ftojë atë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, duke i caktuar atij një afat deri në datën 13.10.2023, brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e tij.

4.1 Në datën 12.10.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për shtyrje të afatit të paraqitjes së parashtrimeve, kërkesë e cila u pranua nga trupi gjykues, duke i caktuar datën 17.10.2023, si afatin brenda të cilit duhet të paraqiste qëndrimin e tij ndaj rezultateve të hetimit.

5. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe administroi një kopje të saj, fakt të cilin edhe e konfirmoi. Ai paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit, të cilat u administruan në dosjen e subjektit të rivlerësimit për t'u vlerësuar në vendimmarrjen përfundimtare.

6. Trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/201, ftoi subjektin e rivlerësimit Mustafa Turku për t'u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 24.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

7. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 24.10.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Subjekti i rivlerësimit në këtë seancë u paraqit personalisht, si dhe deklaroi se do të mbrohej edhe nga përfaqësuesi ligjor i caktuar prej tij, av. F. L., me nr. \*\*\* licence. Gjatë kësaj seance, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij parashtruan qëndrimin e tyre lidhur me rezultatet e hetimit.

8. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Mustafa Turku, në seancën e datës 24.10.2023, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

10. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë në tërësi sipas bindjes së tyre të brendshme çdo *indicie* lidhur me rrethanat e çështjes.

**11.** Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>1</sup>.

**12.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) denoncimet nga publiku;
- ë) informacionet nga burime të hapura;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**13. Pasuria shtëpi banimi – apartament 3 + 1 + shtesa, me sipërfaqe 84.40 m<sup>2</sup>, ndodhur në pallatin \*\*\*, shkalla \*\*\*, ap. \*\*\*, Elbasan.**

**13.1** Në DPV-në e vitit 2003, subjekti deklaron shtëpi banimi me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*”, rruga “\*\*\*” Burimi i krijimit: përfituar nga privatizimi.

**13.2** Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaron legalizim të shtesës së banesës prej 13.9 m<sup>2</sup> nga ALUIZNI Elbasan, në bazë të Lejes së Legalizimit datë 3.12.2015.

**13.3** Komisioni kërkoi informacion<sup>2</sup> pranë ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion<sup>3</sup> rezultoi se:

**13.3.1** Pasuria apartament me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> është përfituar nga shtetasit B. T., F., A., E., M. e S. T. sipas Kontratës nr. \*\*\*, datë 3.10.1994, të lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe shtetasit B. T..

**13.3.2** Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 28.12.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është çelur dëshmia e trashëgimisë për trashëgimlënësen E. T. (gjyshja e subjektit të rivlerësimit), ku si trashëgimtarë ligjorë të saj rezultojnë shtetasit B. T., Gj. T. (B.) dhe F. T..

**13.3.3** Në datën 30.10.1998, me Kontratën e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., shitësit B. T., F. T., S. T., Mustafa Turku, si dhe F. T., Gj. T. dhe A. T. (të përfaqësuar me prokurë nga Mustafa Turku) i shesin blerësit R. L. pasurinë e ndodhur në lagjen “\*\*\*”, pallati \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, të përbërë prej 2 dhoma e një kuzhinë, në shumën 1.480.000 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

**13.3.4** Po në këtë datë, përmes Kontratës së Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.9.1998, pasuria në pronësi të shtetasve R., V. dhe R. L., e ndodhur në lagjen “\*\*\*”, pallati \*\*\*, shkalla nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, e përbërë prej 3 dhoma e një kuzhinë, i është shitur shtetasit Mustafa Turku në shumën 1.980.000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

<sup>1</sup> Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi”.

<sup>2</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021, në dosjen e hetimit.

<sup>3</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, të ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, në dosjen e hetimit.

**13.3.5** Pasuria shtëpi banimi me adresë lagjja “\*\*\*\*” është regjistruar në datën 6.9.2001, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, vetëm në pronësi të subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku, me sipërfaqe totale 82 m<sup>2</sup> dhe është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie në datën 7.12.2005.

**13.4** Duke analizuar deklarinimin e subjektit, deklaruar në DPV-në e vitit 2003, ai e deklaroi si të përfutur nga privatizimi, zotërues i 1/6 pjesë. Nga dokumentacioni rezulton se është përfutur me Kontratë Shitblerjeje datë 30.9.1998 dhe se përfutues i vetëm i kësaj pasurie është subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit.

**13.5** Sipas kontratave respektive të shitblerjes së apartamenteve, diferenca midis çmimeve rezulton të jetë 500.000 (pesëqind mijë) lekë, shumë e cila përputhet edhe me çmimin mesatar të banesave në atë vit (20 m<sup>2</sup> x 23.630 lekë/m<sup>2</sup> = 472.600 lekë). Vetë subjekti i rivlerësimit deklaroi në Deklaratën *Vetting* se me marrëveshje i ka dhënë shtetasit R. L. (shitësit) shumë prej rreth 300.000 lekësh për një dhomë më shumë. Ky deklarinim mbetet i paprovuar/dokumentuar.

**13.6** Objekti “shtesë” është pajisur me Leje Legalizimi datë 3.12.2015 dhe i regjistruar në vijim në emër të subjektit të rivlerësimit. Vlera me preventiv e këtij ndërtimi është 299.820 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet) lekë, sipas dokumentit preventiv të vitit 2019 të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. Kjo vlerë është deklaruar për herë të parë edhe në Deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, deklaruar si e pashlyer.

**13.7** Në DPV-në e vitit 2003 nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit shtesa në apartamentin e banimit, vlera e ndërtimit të saj në shumë 299.820 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet) lekë apo detyrimi në këtë shumë kundrejt shoqërisë ndërtuese, çka nuk gjen përputhje me deklarinimet e subjektit në deklarinatën *Vetting*.

**13.8** I pyetur nga Komisioni<sup>4</sup> sa i përket mënyrës së përfutimit të pasurisë, si dhe çdo deklarinim tjetër lidhur me të, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar: *“Nga shitja e shtëpisë me privatizim ai dhe pjesëtarët e tjerë të familjes nuk kanë përfutur vlerë monetare pasi, në realitet, është bërë këmbim banesash dhe jo pagesë çmimesh, me përjashtim të pagesës prej 300.000 (treqind mijë) lekësh. Si dokumentacion shtesë për këtë shpjegim paraqet deklarinatë noteriale<sup>5</sup> të motrës, shtetas A. B. (T.). Referuar legjislacionit të kohës dhe praktikës noteriale, noteri ka formuluar këmbimin e banesave me kontratë shitjeje. Vlerat e shënuara në kontratë i përkasin vlerësimit të këtyre pasurive në atë kohë. Regjistrimi në emrin e subjektit të rivlerësimit është bërë me pëlqimin e të gjithë pjesëtarëve të familjes, të cilët e kanë autorizuar si për shitjen edhe për blerjen e banesës. Arsyeja që kjo banesë e privatizuar është në emrin e subjektit të rivlerësimit ka të bëjë me praktikën e bërjes sa më shpejt të dokumentacionit të banesës, pasi bashkëpronësia në këtë banesë dhe e pjesëtarëve të tjerë nuk është vënë në diskutim dhe nuk është mohuar asnjëherë. Angazhimi i shumë vetëve me veprimet e kësaj banese do të kërkonte kohë dhe mund të sillte vonesa”*.

**13.9** Në lidhje me shtesën e bërë në banesë subjekti ka deklaruar: *“... ajo është bërë në vitin 2000 me një sipërfaqe prej 14.4 m<sup>2</sup>. Kjo shtesë banese është bërë me leje dhe vendim të Bashkisë Elbasan dhe nga firma ndërtuese “\*\*\*\*”. Vlera e ndërtimit të kësaj shtese ka qenë rreth 300.000 (treqind mijë) lekë. Burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e familjes. Arsyeja e mosdeklarinimit të shtesës së banesës lidhet me faktin se nuk kisha paguar ende detyrimin ndaj firmës ndërtuese dhe nuk kisha marrë ende dokumentin e pronësisë. Mospajisja ende me dokument pronësie dhe mosbërja ligjërish pronar i shtesës ishte arsyeja e mosdeklarinimit. Tapia për ndërtimin e këtij objekti ka dalë shumë vite më pas. Një ndër arsyet e kësaj vonese lidhet me mbylljen e firmës dhe mosgjetjes së dokumenteve preventivuese në bazë të të cilave do të bëhej edhe pagesa për detyrimet si ndaj firmës edhe ndaj shtetit.*

<sup>4</sup> Pyetësorë data 13-25 korrik 2023, në dosjen e hetimit.

<sup>5</sup> Deklaratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.8.2023.

*Si dokumentacion provues subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale<sup>6</sup> (të vitit 2023) të shtetasit I. L., i cili deklaroi se vlerën prej 300.000 (treqind mijë) lekësh të kostos së punimeve për ndërtimin e shtesës ia ka kërkuar subjektit të rivlerësimit në vitin 2019, kur duhet të legalizonte ndërtimin, sipas marrëveshjes së bërë mes tyre”.*

**13.10** Komisioni hetoi<sup>7</sup> në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve me të cilët ai apo personat e lidhur me të kanë pasur lidhje interesi privat, pasuror ose vetjak jopasuror dhe nga hetimi nuk rezultuan të dhëna.

**13.11** Komisioni kreu analizën financiare lidhur me burimin për krijimin e pasurisë apartament 3+1, në vitin 1998, sipas Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.10.1998, në shumën 1.980.000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë [duke llogaritur diferencën mes dy kontratave në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, pa marrë në konsideratë faktin se shtëpia është regjistruar vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa në shtëpinë pararendëse ai ka qenë pronar me 1/6 pjesë]. Analiza financiare për ndërtimin e shtesës në vitin 2000 është kryer duke llogaritur vlerën 299.820 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet) lekë të shlyer në vitin e krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit për shkaqet e shpjguara më lart në këtë vendim.

**13.12** Nga analiza financiare subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare përkatësisht: (i) në vitin 1998, në vlerën -265.031 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e një) lekë; (ii) në vitin 2000 për ndërtimin e shtesës, në vlerën -299.820 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet) lekë. Për më shumë referojuni analizës financiare në *excel* të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor.

**13.13** Lidhur me pasurinë apartament 3 + 1 + shtesa, me sipërfaqe në total 84.40 m<sup>2</sup>, ndodhur në Elbasan, rezulton se:

- a) *Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën Vetting nuk përputhen me deklaramit e tij ndër vite (DPV), si dhe me dokumentacionin ligjor të kohës për të provuar pretendimet e tij.*
- b) *Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, të deklaronte lidhur me këtë pasuri tjetërsimin e saj, si dhe detyrime të prapambetura.*
- c) *Nga analiza financiare subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -564.851 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë.*

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**13.14** Në vijim të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit me prapësimet dhe shpjegimet e tij deklaroi: *“Sikurse kam shpjeguar për Komisionin<sup>8</sup>, nga unë subjekti i rivlerësimit është provuar që shpenzimi ka qenë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë dhe jo 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Duke qenë se R. L. nuk jeton më, nuk kam mundësi tjetër për të provuar këtë fakt. Këtë fakt e pohon deklarimi im i bërë para ILDKPKI-së i vitit 2011 ashtu edhe plotësimi i Deklaratës Vetting në vitin 2016, çfarë do të thotë nëse do të ishte shënuar shpenzimi real në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë për blerjen e apartamentit 3+1 në vitin 1998 nuk do të kishte rezultat financiar negativ. Në të ardhurat e vitit financiar 1998 nuk janë përfshirë me të padrejtë të ardhurat nga pensioni i prindërve të mi B. T. dhe F. T.. Po të përfshihen edhe këto të ardhura në këtë analizë financiare, do të kishim një rezultat pozitiv [mbi 200.000 (dyqind mijë) lekë]. Sa më lart, kërkoj që në analizën financiare të përlllogariten edhe pensionet e prindërve. Në lidhje me ndërtimin e shtesës në vitin 2000 me të padrejtë, Komisioni përfshin në analizën financiare të këtij viti vlerën e shpenzimit prej 300.000 (treqind mijë) lekësh, pasi*

<sup>6</sup> Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në dosjen e pyetësorëve.

<sup>7</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>8</sup> Në referencë të përgjigjeve të pyetësorëve.

është provuar me deklarin të I. L. (ndërtuesit) edhe deklarimet periodike të pasurisë së bërë nga ana ime që kjo vlerë deri në vitin 2016, kohë kur shtrin veprimtarinë deklarimi Vetting, nuk është paguar. Kjo shumë është paguar në vitin 2019, ku unë kam shpjeguar dhe provuar për Komisionin. Po të hiqet vlera 300.000 (treqind mijë) lekë nga analiza financiare e vitit 2000 e përfshirë me të padrejtë si shpenzim, unë si subjekt i rivlerësimit rezultoj me mundësi financiare për pasuritë e mia në vitin 2000. Ka qenë dakordësia midis meje dhe ndërtuesit për të bërë pagesën kur të nxirrja tapinë, e cila ka dalë në vitin 2019”.

**13.15** Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka arsyetuar se llogaritja e pensioneve për prindërit nuk është përfshirë si e ardhur pasi është konsideruar si e ardhur e barabartë me shpenzimin jetik për dy prindërit pensionistë. Po ashtu, edhe motra e subjektit, e cila ka qenë e përfshirë në gjendjen familjare deri në vitin 1995, ajo ka pasur të ardhura vetëm në një vit, as ajo nuk ishte përfshirë në analizën e Komisionit. Nga vlerësimi i situatës pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat edhe të prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe duke arsyetuar sipas vendimit të Kolegjit<sup>9</sup>, nr. 15/2021, paragrafi 21.41, ka llogaritur shpenzimet për jetesë në familjen e subjektit të rivlerësimit (me 4 persona) në masën 30%, referuar të ardhurave të subjektit dhe të ardhurave të prindërve nga pensionet si shpenzime në masën 66%, referuar masës së pensionit.

**13.16** Vlera e shpenzuar për shtëpinë e këmbyer në vitin 1998 është konsideruar 500.000 (pesëqind mijë) lekë, duke mos pranuar shpjegimet e dhëna nga subjekti në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, por duke iu referuar kontratave përkatëse të shitblerjes. Sa i përket kësaj pasurie janë pranuar vetëm pretendimet lidhur me pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit.

**13.17** Vlera për shtesën në vitin 2000 është konsideruar e paguar në atë periudhë, pasi në vlerësim të trupit gjykues shpjegimet e subjektit nuk kanë asnjë logjikë të arsyeshme dhe se ato gjithashtu nuk gjejnë pasqyrim si detyrim në DPV-të përkatëse.

**13.18** Nga analiza financiare e rishikuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare -529.053 (pesëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëdhjetë e tre) lekë për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe totale 84.40 m<sup>2</sup>.

**13.19** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe se ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

**13.20** Për një vlerësim proporcional dhe objektiv kjo situatë negative financiare do të vlerësohet në mënyrë kumulative edhe me situata të tjera financiare ndër vite deri në plotësimin e deklaratës Vetting.

## **14. Pasuria tokë truall**

**i) Sipërfaqe 423 m<sup>2</sup>**, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, blerë me Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.10.1996, nga subjekti i rivlerësimit. Vlera e blerjes së kësaj pasurie është 560.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Burimi i krijimit: kursimet nga paga, paguar me këste.

**ii) Sipërfaqe 240 m<sup>2</sup>**, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, blerë në bazë të Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.1997, nga shtetasi K. G., përfaqësues i pronares së tokës, znj. R. D., e përfaqësuar me Prokurën nr. \*\*\*, datë 29.12.1995, nga ky shtetas. Vlera e blerjes së kësaj sipërfaqeje toke është 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Burimi i krijimit: kursimet nga paga, paguar me këste.

**14.1** Në lidhje me pasurinë e mësipërme subjekti i rivlerësimit deklaroi në DPV-në e vitit 2003 sipërfaqe toke 640 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\* dhe nr. \*\*\*, me vlerë 0.75 (në milion) lekë.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 15/2021, KPA.

**14.2** Nga dokumentacioni ligjor e kadastral i kësaj pasurie rezulton<sup>10</sup> se:

**14.2.1** Sipërfaqja e tokës së blerë nga subjekti i rivlerësimit është përfituar në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.4.1994, të Komisionit të Kthimit të Pronave, Bashkia Elbasan, në emër të ish-pronarit M. D.. Sipas Dëshmisë së Trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 25.8.1993, pronat e kthyerat janë transferuar fëmijëve të tij H., M. dhe R. D.. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.1996, për pjesëtim pasurie të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili ka marrë formë të prerë në datën 15.7.1996, është vendosur pjesëtimi i pasurisë truell prej 4.900 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”.

**14.2.2** Në bazë të Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.10.1996, nga subjekti i rivlerësimit është blerë truall me sip. 423 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasës R. D..

**14.2.3** Në bazë të Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.1997, nga subjekti i rivlerësimit është blerë edhe një pjesë tjetër truall prej 240 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasës R. D..

**14.2.4** Këto pasuri janë shitur nga shtetasi K. G., i përfaqësuar me Prokurën nr. \*\*\*, datë 29.12.1995, nga shtetasja R. D. Të dyja këto pasuri ndodhen në lagjen “\*\*\*\*”.

**14.2.5** Pasuritë e mësipërme janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 8.1.2000, me nr. pasurie \*\*\* dhe nr. \*\*\* dhe janë pajisur me Certifikatë Pronësie në datën 7.12.2005. Statusi aktual i këtyre pasurive, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme, është pa shënime në seksionet C, D dhe E.

**14.3** Subjekti i rivlerësimit është pyetur<sup>11</sup> lidhur me konstatimet e Komisionit gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri dhe nga ana e tij është deklaruar se: *“Truall i blerë ka qenë në bashkëpronësi të disa shtetasve A. A., N. A., Sh. A., H. A., H. D. dhe R. D.. Me vendim gjykatë pasuria me sipërfaqe 4.900 m<sup>2</sup> i është nënshtruar pjesëtimi të saj midis shtetasve të mësipërm, ku është bërë pjesëtimi truallit. Shitësja R. D. ka përfituar sipërfaqen prej 1.363 m<sup>2</sup>. Nga subjekti i rivlerësimit në vitin 1996 është blerë sipërfaqe toke prej 423 m<sup>2</sup>, në shumën 560.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Po nga e njëjta sipërfaqe toke, në vitin 1997 është blerë dhe pjesa tjetër prej 240 m<sup>2</sup>, në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Për shitjen e kësaj prone kjo shtetase në atë kohë kishte autorizuar njeriun e saj me prokurë, shtetasin K. G., me të cilin janë kryer veprimet e blerjes. Burimi i të ardhurave për blerjen e tokës ka qenë angazhimi i prindërve të mi dhe sidomos i babait tim.*

*Shënimi në deklaratën e deklarimit periodik vjetor të vitit 2003 për sipërfaqen e tokës së blerë në vitet 1996 – 1997 duket që është një gabim material i bërë nga ana ime, pasi blerjet dhe vlerat përkatëse të tyre janë të materializuara në kontratat e shitblerjes. Vlera 0.75 milion lekë është lajthitje në të shkruarën nga ana ime, pasi nuk tregon lidhjen me vlerën e këtyre pasurive, si dhe nuk është mënyrë e shkruar e rregullt dhe për sa i përket mënyrës së shkrimit, por duke qenë se deklarimit periodik vjetor i bashkëlidhen kontratat e blerjes nuk ka vullnet të vesuar, pasi nuk e kam fshehur pasurinë.*

*Në lidhje me interesin tim si blerës, duke qenë se nuk kishim banesë tjetër përveç banesës 2+1 të përfituar nga privatizimi, e blemë me idenë që për të ardhmen mbi këtë tokë të ndërtonim banesë, por për shkak të problemeve shëndetësore të prindërve nuk ndërtoam kurrë në tokën e blerë.*

*Një pjesë e kësaj prone është blerë nga shtetasi D. B., i cili është kunati im. E kemi blerë në të njëjtën kohë këtë pronë me idenë që në qoftë se do të ndërtonim të ishim komshinj. Duke qenë se unë hoqa dorë nga ky ndërtim, edhe D. B. vendosi të mos ndërtonte dhe e ka shitur pronën para disa vitesh. Tek toka, pronë e imja, që nga momenti i blerjes së saj nuk ka asnjë lloj ndërtimi apo projekti ndërtimor. Lidhur me statusin e kësaj prone, më 14.7.2023, i jam drejtuar me kërkesë Zyrës së Urbanistikës të Bashkisë Elbasan, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2023, ka kthyer përgjigje lidhur me këtë status”.*

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 20.4.2021, në dosjen e hetimit dhe shkresën nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Pyetësorët e datave 13 dhe 25 korrik 2023, në dosjen e pyetësorëve.

**14.4** Në lidhje me statusin aktual të pasurive nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Elbasan bën me dije se<sup>12</sup> referuar planit të rivevimit (gjatë hartimit të PDV-së) nuk rezulton të ketë ndërtim.

**14.5** Komisioni hetoi<sup>13</sup> në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve me të cilët ai apo personat e lidhur me të kanë pasur lidhje interesi privat, pasuror ose vetjak jopasuror dhe nga hetimi nuk rezultuan të dhëna.

**14.6** Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësitë e subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë tokë truall në shumën 560.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, referuar Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.10.1996 dhe pasurisë tokë truall në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në bazë të Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.1997.

**14.7** Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare në shumën -66.268 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë në vitin 1997 për blerjen e pasurisë tokë truall me sip. 240 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*” (ngjitur me tokën e blerë një vit më parë).

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mundësitë financiare për krijimin e kësaj pasurie.**

**14.8** Në vijim të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Konstatimi i Komisionit mbi rezultatet e hetimit mbi faktin që unë kam qenë në pamundësi financiare në shumën -66.268 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë për blerjen e pasurisë tokë prej 240 m<sup>2</sup> në vitin 1997 është i padrejtë, pasi sikurse kam shpjeguar në DPV, si dhe në pyetësorët e ILDKPKI-së në vitin 2016, si dhe në pyetësorët e Komisionit për blerjen e kësaj pasurie, kanë pasur kontribut me të ardhurat e tyre edhe prindërit e mi me kursimet e tyre nga puna gjatë gjithë jetës së tyre. Është e padrejtë që në analizën financiare të këtyre viteve (1993 – 1996) përfshihen vetëm të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes sime dhe mohohen të ardhurat e prindërve të mi. Me dokumentacion provohet se kemi qenë një familje”.*

**14.9** Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka arsyetuar si më sipër në këtë vendim duke përfshirë të ardhurat e prindërve në ekonominë e përbashkët të familjes. Nga analiza financiare e rishikuar, subjekti i rivlerësimit rezulton në mundësi financiare për krijimin e pasurisë truall prej 240 m<sup>2</sup>, në vitin 1997. Analiza financiare është bërë në mënyrë kumulative për periudhën nga viti 1993 deri në vitin e krijimit të kësaj pasurie, duke përfshirë të ardhurat e bashkëshortëve dhe pensionet e prindërve të subjektit të rivlerësimit.

**15. Pasuria zyrë me sipërfaqe 42.6 m<sup>2</sup>**, pallat në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, në Elbasan. Vlera e pasurisë: 2.000.000 (dy milionë) lekë; pagesa fillestare bërë në shumën 1.000.000 (një milion) lekë me lekë-bono thesari; pjesa e mbetur prej 1.000.000 (një milion) lekësh është shlyer si hua me këste, pa interes dhe pa afat kohor, nga viti 2007 deri në vitin 2012 ndaj të afërmeve të subjektit, Z. T. dhe M. T.. Burimi i krijimit: të ardhurat në depozitë bono thesari nga llogaria nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, si dhe nga të ardhurat nga paga, shlyer në vite me këste.

**15.1** Pasuria “zyrë” është blerë sipas Kontratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.6.2007, me palë shitëse Z. O. T. dhe M. O. T. dhe palë blerëse M. B. T. e S. Dh. T., në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë, deklaruar e likuiduar tërësisht po atë ditë në formën *cash*, jashtë zyrës noteriale, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\* pasurie, z. k. \*\*\*, datë 28.6.2007.

**15.2** Në DPV-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e pasurisë në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë, paguar me bono thesari në shumën 1.000.000 (një milion) lekë,

<sup>12</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2023, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Elbasan, në dosjen e pyetësorëve.

<sup>13</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, në dosjen e hetimit.



ndërsa pjesa tjetër në shumën 1.000.000 (një milion) lekë me hua pa afat e pa interes shtetasve Z. O. T. e M. O. T..

**15.3** Nga verifikimi i DPV-ve ndër vite rezulton se subjekti deklaroi përkatësisht:

- në vitin 2009, shlyer shuma 300.000 (treqind mijë) lekë, shuma 700.000 (shtatëqind mijë) lekë ende e pashlyer;
- në vitin 2010, shlyer shuma 300.000 (treqind mijë) lekë, shuma 400.000 (katërqind mijë) lekë ende e pashlyer;
- në vitin 2011, shlyer shuma 200.000 (dyqind mijë) lekë, shuma 200.000 (dyqind mijë) lekë ende e pashlyer;
- në vitin 2012 deklaroi shlyerjen e plotë të huas.

**15.4** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, ka sqaruar se: *“Për blerjen e zyrës në vitin 2007, nga vlera e saj prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh janë paguar në momentin e blerjes 1.000.000 (një milion) lekë dhe pjesa tjetër prej 1.000.000 (një milion) lekësh është paguar më pas gradualisht, me këste [duke dorëzuar çdo muaj këstin prej 25.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh shitësit M. O. T. dhe duke marrë prej tij shënimin për konfirmimin e marrjes së shumës]. Paga e shumës fillestare prej 1.000.000 (një milion) lekësh është bërë me kursimet e marra nga banka (bono thesari) dhe pjesa tjetër është bërë gradualisht në vite, me këste dhe ka përfunduar në vitin 2012. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratë noteriale<sup>14</sup> të shitësit M. O. T., i cili deklaroi shitjen e pasurisë subjektivit të rivlerësimit, dhënien e huas dhe shlyerjen e saj sipas mënyrës së cituar më sipër”.*

**15.5** Në një vlerësim të përgjithshëm të situatës Komisioni ka vërejtur se huaja e deklaruar nuk ka një logjikë juridike, pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur likuiditete të mjaftueshme (cash dhe në bankë) në dispozicion për likuidimin e plotë të vlerës, si dhe vetë kontrata e nënshkruar prej palëve, me vullnet të lirë, ka paraqitur shprehimisht faktin se kjo vlerë u likuidua e plotë paraprakisht. Gjithashtu, palët mund të kishin hartuar një kontratë shitjeje me rezervë të pronës, në zbatim të nenit 746 të Kodit Civil. Palët janë paraqitur te noteri për hartimin e kontratës së shitjes dhe fare mirë mund të përpilonin edhe një kontratë huaje, nëse vërtet do të ekzistonte vullneti i blerësit për të huazuar shumën 1.000.000 (një milion) lekë. Është e vërtetë që kontrata e huas nuk është formale dhe për vlefshmërinë e saj nuk është e nevojshme forma shkresore, por forma shkresore është e nevojshme për provueshmërinë e kryerjes realisht të veprimit juridik. Në nenin 83, paragrafi i dytë i Kodit Civil është përcaktuar qartësisht që këto veprime juridike, për të cilat forma e shkruar nuk është kriter vlefshmërie, nuk mund të provohen me dëshmitarë. Deklarata noteriale, e depozituar gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve, është një akt i shkruar në formë, por në përmbajtje ka elementet e dëshmisë, për sa kohë aty janë pasqyruar thëniet e shtetasit M. O. T.. Për rrjedhojë, kjo deklaratë noteriale nuk mund të shërbejë si provë për ekzistencën e veprimit juridik të huas.

**15.6** Komisioni ka hetuar<sup>15</sup> në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi ndërmjet subjektivit të rivlerësimit dhe shtetasve me të cilët ai apo personat e lidhur me të kanë pasur lidhje interesi privat, pasuror ose vetjak jopasuror dhe nga hetimi nuk rezultuan të dhëna.

▪ **Analiza për burimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë**

**15.7** Në DPV-në e vitit 2006 subjekti deklaroi mbylljen në datën 21.7.2006 të llogarisë nr. \*\*\* në bono thesari, në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, dhe kaluar likuiditet në shtëpi, si dhe mbylljen në datën 27.10.2006 të llogarisë nr. \*\*\* në bono thesari, në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe kaluar likuiditet në shtëpi.

**15.8** Nga informacioni i përcjellë nga Raiffeisen Bank<sup>16</sup> rezultoi se nga llogaria nr. \*\*\* në emër të subjektivit të rivlerësimit Mustafa Turku janë tërhequr prej tij përkatësisht shumat 546.800 (pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind) lekë në datën 20.7.2006 dhe 505.118 (pesëqind e pesë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë në datën 27.10.2006.

<sup>14</sup> Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.7.2023, në dosjen e pyetësorëve.

<sup>15</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>16</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021, në dosjen e hetimit.

**15.9** Komisioni vlerësoi dhe analizoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për pagesën e kryer për blerjen e pasurisë “zyrë” në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë, duke vlerësuar ta llogarisë atë sipas përcaktimeve në Kontratën Noteriale nr. \*\*\* rep. nr. \*\*\* kol., datë 6.6.2007.

**15.10** **Sa më sipër ka rezultuar** se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor marrjen e huas dhe shlyerjen e saj, të cilat mbeten në nivel deklarativ, si dhe nuk bëjnë logjikë për sa kohë vetë subjekti ka deklaruar e pranuar në kontratë se ka shlyer totalisht çmimin e kësaj kontrate e se ai dispononte gjendje të likuiditeteve cash në shtëpi (deklaruar prej tij). Subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën - 1.000.000 (një milion) lekë me të ardhura nga burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2007.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**15.11** Në vijim të rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon: “Në lidhje me zyrën dhe rezultatet e hetimit Komisioni ka dalë jashtë tagrave të disponimit apo diskrecionit që ligji i ka vënë në veprimtarinë e saj, duke dalë në deduksione të pabazuara në prova. Nga ana e Komisionit pranohet që nga ana e subjektit rivlerësues ka pasur të ardhura për blerjen e pasurisë zyrë, pasi ka deklaruar para gjendje që do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk kishte arsye për të bërë një deklaram ndryshe nga sa rezulton në realitet. Komisioni pranon që nga deklaramet periodike, si dhe te deklarama noteriale e M. O. T. rezulton që shuma prej 1.000.000 (një milion) lekësh është paguar me këste, çfarë do të thotë që provohet me dokumentacion që shuma 1.000.000 (një milion) lekë nuk është paguar në vitin 2007 dhe jo që mbetet një provueshmëri deklarative. Pavarësisht përdorjes së termit “hua” kuptohet që nuk kemi të bëjmë me një hua në kuptimin parësor të fjalës, por me një pagim me këste të çmimit të blerjes. Ky ka qenë vullneti i palëve që vetë Komisioni pranon që nuk është një veprim në kundërshtim me ligjin dhe dukshëm përfshirja e vlerës 2.000.000 (dy milionë) lekë në vitin 2007 nga Komisioni është e padrejtë. Nëse shpenzimi i vitit 2007 do të ishte përllogaritur 1.000.000 (një milion) lekë, dukshëm nuk do të kishim një rezultat të tillë. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë bindëse, shteruese dhe dukshëm rezulton që kemi të bëjmë me një marrëdhënie familjare. M. O. T. është djali i xhaxhait të babait dhe marrëdhënia e krijuar është një marrëdhënie me vullnet të lirë dhe askush nuk mund ta ndryshojë. Babai i M. O. T. është vëllai i gjyshit tim M. T. dhe vendi ku është ndërtuar pallati ku ndodhet zyra e subjektit të rivlerësimit ka qenë shtëpia ku ka jetuar gjyshi im dhe ku ka lindur babai im”.

**15.12** Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit në raport me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, çmon se për sa kohë marrëdhënia mes palëve është pranuar dhe nuk ka sjellë konflikt e se ajo është një marrëdhënie mes të afërmeve, që krijon besueshmëri e, gjithashtu, e deklaruar nga vetë subjekti përmes deklaramave periodike, shuma prej 1.000.000 (një milion) lekësh duhet pranuar si e paguar nga subjekti me këste, sipas deklaramit duke i dhënë në këtë rast besueshmëri deklaramit të tij në DPV, deklarame këto të konfirmuara (të pakundërshtuara) nga përfituesit e kësaj shume.

Trupi gjykues në përfundim vlerëson se mospërputhjet mes kontratës së shitblerjes dhe deklaramit periodik vjetor e atij *Vetting* nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase ndëshkuese ndaj subjektit të rivlerësimit.

**16. Pasuria truall dhe ndërtesë me nr. \*\*\* në emër të nënës së subjektit**, e cila figuron bashkëpronare e pasurive me sipërfaqe trualli 94.3 m<sup>2</sup> e ndërtesë (një kat) prej 66.14 m<sup>2</sup> (radh. \*\*\*, datë 18.10.2010). Burimi i krijimit: trashëgimi ligjore nga nëna. Pjesa takuese: 100% e trashëgimtarit.

**16.1** Në Deklaramen *Vetting* nga subjekti është deklaruar se sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, të lëshuar nga noteri S. D., nëna e tij ka lënë Testamentin nr. \*\*\*, datë 10.11.2010, për pasurinë nr. \*\*\* në pjesën takuese me 1/6 pjesë të pandarë në bashkëpronësi, pronë e trashëguar nga babai i saj. Në dijeninë e subjektit, shtëpia e gjyshit të tij (babait të nënës), që nga vitet 1930 figuron pa tapi. Para vdekjes (nëna ka ndërruar jetë më 20.12.2012) pjesën

takuese të saj ia ka lënë testament nipit të saj, djalit të vëllait, shtetasit I. Xh. Z.. Edhe sot e kësaj dite ky testament nuk është çelur prej trashëgimtarit testamentar.

**16.2** Referuar dokumentacionit<sup>17</sup> lidhur me këtë pasuri, rezulton se sipas regjistrimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 18.10.2010, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, truall me sip. 94.3 m<sup>2</sup> me ndërtesë dykatëshe, ku kati i parë është 66.14 m<sup>2</sup> dhe kati i dytë 47.15 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Elbasan. Pasuria është e regjistruar në emër të 22 bashkëpronarëve trashëgimtarë të familjes Z., ku shtetasja F. T. zotëron 1/6 pjesë.

**16.3** Komisioni ka vlerësuar se deklarimi i pasurisë në Deklaratën *Vetting* përputhet me dokumentacionin ligjor të kësaj pasurie, por subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar ndonjë akt ligjor që provon pronësinë apo të drejta reale mbi pasurinë e deklaruar.

**16.4** Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë konstatim.

**16.5** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Dikur në vitet 1930 gjyshi im, nga nëna, ka pasur tri shtëpi, nga të cilat dy njëkatëshet (që janë ngjitur me dykatëshen ekzistuese) janë shitur dhe ka mbetur shtëpia dykatëshe. Prej vitesh shtëpia ekzistuese ka qenë pa tapi, e pa bërë nga im gjysh. Shtimi i numrit të bashkëpronarëve ligjore në këtë shtëpi e ka bërë të pamundur edhe sot e kësaj dite nxjerrjen e tapisë. Ishte amaneti i nënës sime që ta mbyllte këtë detyrim që ajo kishte ndaj vëllait të saj të ndjerë duke ja dhënë pjesën e saj takuese djalit të vogël të tij I. Z.. Veç testamentit të nënës dhe pjesës së saj takuese nuk disponoj asnjë lloj dokumentacioni të pronës”.*

**16.6** Trupi gjykues çmon se bazuar në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kuptim të neneve 316 dhe 317 të Kodit Civil, deklarimi i kësaj pasurie në Deklaratën *Vetting*, me burim krijimi trashëgiminë ligjore nga nëna, mbetet i pasaktë dhe i paprovuar me dokumentacion justifikues, por pa relevancë për procesin e rivlerësimit.

**17. Pasuria apartament banimi (garsoniere) me sipërfaqe 33,84 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Kavajë,** regjistruar me Certifikatë Pronësie nr. \*\*\*, datë 21.11.2005, me nr. \*\*\* pasurie, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në emër të bashkëshortes së subjektit, përfutur sipas Kontratës së Shitblerjes datë 18.11.2005. Vlera e pasurisë 300.000 (treqind mijë) lekë, e cila është vlera e kostos reale të ndërtimit të garsonierës. Garsoniera i është dhënë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga i vëllai D. B., në këmbim të pjesës takuese të falur nga ana e saj, pas shitjes së banesës së familjes, konfirmuar me Kontratë Shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.11.2005. Burimi i krijimit: dhënë nga i vëllai, ndonëse veprimi është bërë me akt shitjeje për efekt dokumentimi. Pjesa takuese: 100% në pronësi të bashkëshortes.

**17.1** Lidhur me pasurinë nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit deklaron:

a) Në DPV-në e vitit 2005 apartament banimi (garsoniere), sip. 33 m<sup>2</sup>, \*\*\*, në emër të bashkëshortes, deklaruar e blerë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë (vlera e ndërtimit).

b) Në DPV-të e viteve 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010 deklaron të ardhura të përfuturara nga dhënia me qira e garsonierës në vlerën 180.000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë për çdo sezon turistik (qershor - shtator).

**17.2** Komisioni kërkoi informacion pranë ASHK, Kavajë, nga ku rezulton<sup>18</sup>:

**17.2.1** Me Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 17.11.1998, shitësi I. D. i ka shitur blerësit R.T. sipërfaqen 500 m<sup>2</sup> tokë arë, me nr. pas. \*\*\*, z. k. \*\*\* (K., Kavajë), në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, së bashku me të drejtën e përdorimit të Lejes së Ndërtimit nr. \*\*\*, datë 4.6.1998, të marrë prej tij për këtë pasuri.

**17.2.2** Në datën 28.5.2001, shitësi R. T. deklaron se ka në pronësi 250 m<sup>2</sup> tokë arë, të cilën ua shet blerësve N. T., D. B. (vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) dhe S. S. me Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., secilit nga ¼ pjesë të barabartë (duke përfshirë edhe veten), kundrejt çmimit 100.000 (njëqind mijë) lekë, e shlyer jashtë zyrës noteriale.

<sup>17</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>18</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2023, në dosjen e hetimit.

**17.2.3** Sipas Certifikatës së Pronësisë datë 8.6.2001 rezulton se shtetasit N. T., D. B., S. S. dhe R. T. janë pronarë të pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, prej 250 m<sup>2</sup>. Në këtë pasuri, këta shtetas, në cilësinë e investitorit, kanë ndërtuar godinën prej 5 kate, me vlerë investimi 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë, me shoqërinë e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k.

**17.2.4** Referuar Kontratës së Pjesëtimit të Pasurisë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2004, shtetasit e lartpërmendur kanë kryer pjesëtimin e pasurisë, ku shtetasi D. Dh. B. rezulton pronar i pasurisë apartament nr. \*\*\*, me sip. 33.84 m<sup>2</sup>, sipas Certifikatës së Pronësisë datë 2.6.2004.

**17.2.5** Pasuria është regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit, përfituar sipas Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.11.2005, pajisur me Certifikatë Pronësie nr. \*\*\*, datë 21.11.2005.

**17.3** Në funksion të hetimit, Komisioni ka kërkuar informacion nga FSHU<sup>19</sup>-ja dhe SHUK<sup>20</sup>-u Durrës për kontrata shërbimi të lidhura për pasurinë. Nga korrespondenca me FSHU-në rezulton se në emër të shtetases S. dhe Dh. T. nuk rezulton të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike, por referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI, në datën 24.3.2016, subjekti i rivlerësimit deklaron se kontrata e lidhur me FSHU-në për këtë pasuri, për shkak të një gabimi, ekziston me gjeneralitetet M. M., duke rezultuar ende e pakorrigjuar.

**17.4** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur lidhur me këtë pasuri të bashkëshortes, deklaron: *“Bashkëshortja ka qenë bashkëpronare në banesën apartament (2 + 1 + aneks) të prindërve të saj së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes (babai, nëna, vëllai dhe kunata), pronë e shitur më parë në vitin 2004, dokument të cilin jua kam vënë në dispozicion në deklaratimet e mëparshme. Pas vdekjes së nënës së saj, shtëpia është shitur. Me vullnetin e saj bashkëshortja pjesën e saj takuese nga nëna ia dha të vëllait, shtetasit D. B., i cili përfitoi çmimin e shitjes së banesës në tërësi. Nga ndërtimi i bërë në Golem nga i vëllai, ai i dha asaj garsonierën e përmendur me sipër në gjendje karabina (të pambaruar), e përfunduar dhe e plotësuar më pas gradualisht. Veprimi i kryer midis tyre është bërë me akt shitblerjeje, ndonëse nuk janë paguar lekë, por vlera e saj është kosto ndërtimi. Vlera që bashkëshortja ka përfituar është garsoniera dhe sikurse është deklaruar vlera e saj ka qenë vlerësuar 300.000 (treqind mijë) lekë. Kjo mënyrë ndarjeje ka qenë midis pjesëtarëve të familjes së bashkëshortes”*.

**17.5** Në lidhje me shpenzimet për arredim të banesës, subjekti deklaron se ka kryer 30.000 (tridhjetë mijë) lekë investim kur e ka marrë objektin (dyer e dritare) dhe 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në vitin 2013 (mobilie kuzhine).

**17.6** Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokument apo kontratën e shitjes së pasurisë së prindërve të bashkëshortes, ku të provohet pretendimi i tij lidhur me dhurimin. Nga ana e tij është paraqitur si dokumentacion shoqërues një deklaratë noteriale e kunatit të tij, shtetasit D. B.<sup>21</sup>, i cili deklaron se në vitin 2004 ka shitur banesën 2 + 1, në bashkëpronësi të tij, nënës, babait dhe bashkëshortes dhe me ato të ardhura ka blerë një banesë 3 + 1 + 1 në Elbasan. Për shkak të ndarjes nga jeta të nënës së tyre, bashkëpronare është bërë edhe motra e tij S. T., e cila ka pranuar të marrë pjesën e saj të bashkëpronësisë në një moment të mëvonshëm. Shtetasi D. B. deklaron se nuk kanë hartuar dokument të shkruar për shkak të marrëdhënies familjare.

**17.7** Komisioni hetoi<sup>22</sup> në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij me shtetasit/palët që kanë marrë pjesë në këtë marrëdhënie (investitor/ndërtues/pronarë, ish-pronarë) dhe nga hetimi nuk rezultuan të dhëna për hetime të mëtejshme.

**17.8** Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, duke marrë në konsideratë vlerën sipas kostonë së ndërtimit sipas EKB-së në vitin 2005 (kostoja e ndërtimit në Kavajë në vitin 2005 është 25.012 lekë/m<sup>2</sup> x 33.84 m<sup>2</sup> = 846.407

<sup>19</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023.

<sup>20</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2023; nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2023; nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2023.

<sup>21</sup> Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në dosjen e pyetësorëve.

<sup>22</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 24.07.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, në dosjen e hetimit.

lekë), si dhe analizoi mundësinë e tij për pagesën e kryer për blerjen e pasurisë garsoniere në shumën 846.407 (tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatë) lekë në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime arredimi në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në vitin 2013, e cila është pasqyruar në analizën financiare. Investimet e deklaruara prej tij nuk janë llogaritur shtesë, pasi është marrë për referencë kostoja e ndërtimit.

**17.9** Në përfundim lidhur me këtë pasuri ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2005, në shumën -724.935 (shtatëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**17.10** Në vijim të tyre, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Komisioni në mënyrë të padrejtë ka vendosur si shpenzime vlerën sipas koston së ndërtimit të marrë nga EKB-ja, në vlerën 846.400 (tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekësh, pasi është provuar nga subjekti i rivlerësimit që ky ndërtim nuk është bërë nga Mustafa Turku, por nga D. B.. e pasaktë dhe për shtetasin D. B. është përlllogaritja e koston së ndërtimit në vlerat e EKB-së për vitin 2005, pasi ndërtimi është bërë në vitin 2000. Është e dukshme që pamundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2005 është futja e kësaj vlere ndërtimi, ku ky është një shpenzim që nuk është bërë nga subjekti i rivlerësimit. Bashkëlidhur pyetësorëve kam dërguar kontratën e shitjes së pasurisë së bashkëshortes ( ish-shtëpisë së saj)<sup>23</sup>. E përsëris që për garsonierën nuk është paguar asnjë lek, pasi ajo i është dhënë nga i vëllai në mirënjohje që bashkëshortja ime i fali pjesën e saj takuese nga apartamenti që u shit më parë ku ajo ishte bashkëpronare. Për garsonierën nuk është paguar asnjë lek nga unë dhe vlera prej 300.000 (treqind mijë) lekësh e vendosur në kontratën e shitjes është vlera e ndërtimit si karabina e këtij objekti. Ana formale e aktit të dhënies së objektit është i konfirmuar me akt shitjeje, por që në fakt është dhurim i bërë nga vëllai për të motrën. Sa më lart, edhe për vitin 2005, po të hiqet shpenzimi i pakryer i përfshirë në analizë financiare, është një rezultat financiar pozitiv dhe jo negativ. Ndërtimi i garsonierës nuk ka filluar në vitin 2005, por në vitin 2000 dhe kostoja e ndërtimit duhet të marrë për bazë çmimet e atij viti dhe jo të pesë viteve më pas”.*

**17.11** Në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin, arriti në konkluzionin se ndërtimi ishte kryer nga ndërtuesit rreth viteve 2002 – 2003 dhe vetë objekti ishte kolauduar në shtator të vitit 2003<sup>24</sup>, ndaj rillogaritja vlerën e pasurisë sipas koston së ndërtimit të EKB-së<sup>25</sup> për vitin 2003, e cila rezultoi në shumën 837.709 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntë) lekë. Njësia e Shërbimit Ligjor kreu rillogaritjen në analizën financiare të vlerës sipas çmimeve të EKB-së në vitin 2003 (viti i ndërtimit 2002 – 2003), vendosi shpenzimet për arredim në vitin 2005 në shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë sipas deklaramit në pyetësorin standard, si dhe përfshiu në këtë analizë edhe të ardhurat nga pensionet e prindërve të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të kësaj analize, subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2005, në shumën -611.683 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

**17.12** Trupi gjykues vlerësoi t’i qëndrojë konstatimit fillestar për llogaritjen e vlerës së garsonierës sipas kostove të EKB-së. Kjo për faktin se mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarimet e pasakta dhe të ndryshme në deklaratën *Vetting*, si dhe ato gjatë hetimit administrativ mbi përfitimin e kësaj pasurie, të cilat nuk gjetën zbatim as në ndonjë dokument të kohës apo në kontratën e shitblerjes së shtëpisë së prindërve të bashkëshortes, e çuan trupin gjykues në konkluzionin se nga tërësia e tyre nuk u arrit të provohej në ndonjë formë të dokumentuar dhurimi i kësaj pasurie, e cila është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

<sup>23</sup> Shihni Kontratën e Shitblerjes së Pasurisë së Paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.4.2004.

<sup>24</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>25</sup> Kostoja e EKB-së për vitin 2002 është 1.143.622 (një milion e njëqind e dyzet tre mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekë.

**17.13** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë me dokumentacion justifikues përfitimën e pasurisë në pronësi të bashkëshortes, sipas nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe se ai rezulton në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në shumën -611.683 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

**17.14** Për një vlerësimin proporcional dhe objektiv kjo situatë negative financiare do të vlerësohet në mënyrë kumulative edhe me situata të tjera financiare ndër vite deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

**18. Pasuria e llojit truall nr. \*\*\*, me sipërfaqe 160 m<sup>2</sup>**, nga ku ndërtesë 82.6 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, z. k. \*\*\*, Elbasan, regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në emër të bashkëshortes S. Dh. T. Burimi i krijimit: trashëgimtare ligjore e pronares trashëgimlënëse M. S. A.. Pjesa takuese: pjesë e trashëguar dhe e pandarë në pjesë, në bashkëpronësi me të tjerë.

**18.1** Për herë të parë e ka deklaruar pasurinë nr. \*\*\* në deklaratën *Vetting*, si pasuri e trashëguar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga nëna e saj.

**18.2** Komisioni kërkoi<sup>26</sup> informacion pranë ASHK-së, ku sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria Vendore e ASHK-së<sup>27</sup> Elbasan shtetasja S. T. figuron bashkëpronare në pasurinë nr. \*\*\*, regjistruar në datën 24.11.2006 në emër të shtetasve F. A., L. A., Dh. B., D. B. dhe S. T., në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan.

**18.3** Pasuria është regjistruar në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 14.9.2006 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.9.2006), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për vërtetimin e faktit juridik se trashëgimtarët ligjorë të së ndjerës M. B. janë bashkëshorti i saj Dh., si dhe fëmijët D. dhe S. T., të cilët trashëgojnë nga 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore të saj.

**18.4** Rezulton se në DPV-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pasurinë e fituar në emër të bashkëshortes sipas pjesës takuese.

**18.5** I pyetur për këtë fakt nga ILDKPKI-ja në procesverbalin e datës 24.3.2016, subjekti sqaron: *“Shtëpia është përfitur nga nëna e bashkëshortes dhe dy tezet e saj dhe meqenëse ka vetëm pjesën takuese të pronësisë, por asnjë kontribut, nuk është parë e arsyeshme të deklarohet pjesa takuese e përfitur”*.

**18.6** Sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar detyrimin ligjor në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe nenit 33, pika 5/a, për të deklaruar pasurinë e përfitur nga bashkëshortja në vitin 2006, duke mos deklaruar me saktësi pasurinë e përfitur dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

**18.7** Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me këto mosdeklarime ndër vite nga ana e tij.

**18.8** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Në lidhje me pasurinë “shtëpia e tezes së bashkëshortes”, sikurse ju kam dhënë shpjegime më parë, në momentin që bashkëshortja ime ka ardhur në dijeni të kësaj pasurie, e kam deklaruar dhe realisht edhe ligjërisht jemi vënë në dijeni të këtij fakti si unë dhe bashkëshortja, kur nga ASHK-ja na janë vënë në dispozicion dokumentet e vërtetuara. Sa për dijeni, shtëpia për të cilën bëhet fjalë i ka mbetur fëmijëve të tezes së vogël të bashkëshortes dhe pas vdekjes së saj e kanë tre fëmijët e saj, që ndodhen jashtë vendit në Kanada dhe Greqi. Kjo shtëpi ka qenë në emër të gjyshes së saj, pronë e trashëguar nga familja e saj. Kjo shtëpi ju la nga gjyshja tre vajzave të saj, ku e ëma e bashkëshortes sime ishte vajza e dytë. Ky vullnet i gjyshes është sot prezent, me të vetmin ndryshim se trashëgimtarët të kësaj pasurie janë nipër e stërnipër (gjithsej 9 trashëgimtar ligjorë). Por, pavarësisht sa parashtruam përmbledhtas më lart, bashkëshortja ime realisht nuk ka për të qenë asnjëherë bashkëpronare në atë shtëpi, pavarësisht se është e tillë, ajo shtëpi është e tezes së vogël dhe do ta trashëgojnë tre fëmijët e saj”*.

<sup>26</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021, në dosjen e hetimit.

<sup>27</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, në dosjen e hetimit.

**18.9** Trupi gjykues vlerëson se pamjaftueshmëria e deklaramit për deklarimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaramit të pasaktë, mbetet një element që konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili u ka njohur vlerën e provës deklaratave periodike të pasurisë.

**18.9.1** Në rastin konkret, trupi gjykues çmon të theksojë se në rastin konkret burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë rezulton përmes një veprimi të ligjshëm juridik, trashëgimisë ligjore, mbi të cilën nuk vërehen *indicie* se nga subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur janë kryer investime apo dyshime të tjera lidhur me këtë pasuri, ndaj trupi gjykues vlerëson ta konsiderojë atë pa relevancë për procesin. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar pasaktësitë e konstatuara në deklarimet periodike në Deklaratën *Vetting*.

**19. Pasuria automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, blerë me Kontratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.2.2000, në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë. Subjekti deklaron se automjeti është ende në përdorim të tij në momentin e deklaramit. Burimi i krijimit: kursime nga pagat, shlyer me këste. Pjesa takuese: 100%.**

**19.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaramit në DPV-në e vitit 2003: “*Automjet tip “Mercedes-Benz \*\*\*”. Vlera/milionë: 0,55. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursime nga pagat*”.

**19.2** Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaramit se në vitin 2000 ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë (blerë nga babai). Subjekti i rivlerësimit ka deklaramit gjatë pyetësorëve se nuk ka ndryshime në deklaramit, si për vlerën e pasurisë, ashtu edhe për krijimin e saj, pasi automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, është blerë në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, nga e cila 550.000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë i janë dhënë shitësit në atë kohë dhe pjesa tjetër prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh i janë dhënë më pas. Në vitin 2003 ishte paguar vetëm vlera 550.000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh dhe, për këtë arsye, është pasqyruar kjo vlerë në deklaramit. Në Deklaratën *Vetting* është pasqyruar vlera 700.000 (shtatëqind mijë) lekë sepse ishte shlyer vlera e plotë, duke shpjeguar se pasuria është blerë me këste. Në të dyja deklarimet, si në deklaramitën *Vetting*, ashtu edhe në deklaramitën e vitit 2003, burimi për krijimin e kësaj pasurie është deklaramit “Kursime nga pagat”, duke shtuar termin “Shlyer me këste” në Deklaratën *Vetting*. Bashkëlidhur, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaramitën noteriale të shtetasit M. C. (shitësi i automjetit), i cili deklaron të njëjtat rrethana si të subjektit të rivlerësimit, duke shtuar faktin se shumën prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh e ka marrë pas vitit 2003.

**19.3** Komisioni kërkoi<sup>28</sup> informacion pranë DPSHTRR-së Tiranë, e cila ka përcjellë<sup>29</sup> dokumentacionin ligjor e teknik të dosjes së automjetit, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin me Kontratën e Shitjes datë 24.2.2000, vërtetuar përpara noterit me nr. akti \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.2.2000, me palë shitëse A. B., përfaqësuar nga shtetasi M. C. (Prokurë e Posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.11.1999), për çmimin 700.000 (shtatëqind mijë) lekë.

**19.4** Sipas të dhënave nga sistemi AMF, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e pronarit dhe përdoruesit të automjetit.

**19.5** Komisioni hetoi<sup>30</sup> në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nga ku nuk rezultuan të dhëna.

**19.6** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit në vitin 2000, në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, duke e konsideruar të plotë vlerën e likuiduar të automjetit, nga ku subjekti rezulton në pamundësi financiare në shumën -549.975 (pesëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

<sup>28</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>29</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>30</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, në dosjen e hetimit.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**19.7** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Për sa i përket mundësisë së blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, makina është blerë nga im atë me të ardhura të siguruara prej tij. Sqaroj se dhe pas daljes së babait tim në pension në vitin 1994 dhe deri në vitin 2004 ai nuk ka ndenjur për asnjë moment pa punë. Për shkak të reputacionit që kishte si shofer dhe shkallës së gjerë shoqërore të njohjes në Elbasan, ai pati mundësinë e punësimit tek disa subjekte private, duke marrë të ardhura të padeklaruara. Kujtoj se ka punuar si shofer me subjektin, firmë private distributor i shpërndarjes së birrës maqedonase “\*\*\*”, me qendër në Elbasan, shtetasin Z. P., ish-inxhinier në K. M. Elbasan dhe sot prej vitesh në Kanada. Këtë mjet unë e kam dhe sot në përdorim dhe e ruaj në respekt të tim eti. Shtoj se lekët e mjetit nuk janë dhënë menjëherë, por me këste”.*

**19.8** Në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit (deklarimet e tij) vijnë në kontradiktë me deklarimet periodike e duket se vijnë nga pamundësia e tij për të justifikuar burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2000 me të ardhura të ligjshme. Burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ dhe shpjegimeve të dhëna prej tij, është i ndryshëm nga ai i deklaruar prej vetë atij në DPV dhe në Deklaratën *Vetting*. Mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarimet e pasakta dhe kontradiktore në Deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ mbi burimin financiar, që ka shërbyer duke e ndryshuar atë, si dhe pamundësia për të provuar një burim të ligjshëm të të ardhurave për likuidimin e shumës sipas kontratës, e bëjnë në këtë rast deklarimin e subjektit të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**19.8.1** Në vijim, nga analiza kumulative për periudhën 1993 – 2000 (viti i krijimit të kësaj pasurie), e rishikuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor (duke përfshirë edhe të ardhurat e prindërve nga pensioni në masën e shpjeguar më lart në këtë vendim), subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me të ardhura nga burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën -372.019 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë.

**19.9** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm në Deklaratën *Vetting* e se ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

**19.10** Për një vlerësimin proporcional dhe objektiv kjo situatë negative financiare do të vlerësohet në mënyrë kumulative edhe me situata të tjera financiare ndër vite deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

**20. Pasuria automjet tip “Opel Corsa 1.2”**, me targë \*\*\*, blerë sipas Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.2.2009, në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: blerë me paratë e shitjes së automjetit tip “Renault Clio” në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë dhe shuma shtesë prej 300.000 (treqind mijë) lekësh nga të ardhurat nga paga.

**20.1** Nga verifikimi rezulton se subjekti i rivlerësimit deklaron në DPV-në e vitit 2009 blerje automjeti tip “Opel”, me targë \*\*\*, në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, sipas Kontratës së Shitblerjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.2.2009.

**20.2** Në pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit deklaron se<sup>31</sup> në vitin 2009 është blerë automjeti tip “Opel” në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, me burim krijimi 400.000

<sup>31</sup> Pyetësin standard (pyetja nr. 9), në dosjen e pyetësorëve.



(katërqind mijë) lekë nga shitja e automjetit tip “Renault” në vitin 2008 dhe pjesa tjetër me kursime nga pagat dhe të ardhurat e tjera.

**20.3** Nga verifikimi i deklarimeve ka rezultuar se në DPV-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Renault Clio”, në datën 6.9.2007, me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., blerë në emër të bashkëshortes në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë.

**20.4** Në DPV-në e vitit 2008, subjekti deklaroi shitjen e automjetit tip “Renault”, me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.11.2008, në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë deklaruar kurime apo gjendje *cash* të kësaj vlere në DPV-në e vitit 2008.

**20.5** DPSHTRR-ja informon<sup>32</sup> Komisionin se për automjetin tip “Opel Corsa” personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja) e ka blerë atë me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.2.2009, me palë shitëse A. B. dhe palë blerëse S. T., kundrejt shumës 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, e cila është shlyer nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

**20.6** Për automjetin tip “Renault Clio” me targë \*\*\*, vit prodhimi 1996, rezultoi<sup>33</sup> se, sipas Deklaratës Doganore datë 4.7.2008, ky automjet ka kushtuar 100 (njëqind) euro. Sipas Faturës Tatimore të shitjes datë 6.9.2007, automjeti është blerë nga shtetasja S. T., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në shumën 252.000 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë. Me Kontratën e Shitblerjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.11.2008, automjeti tip “Renault Clio” me targë \*\*\* është shitur nga shtetasja S. T. në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë te blerësi F. L..

**20.7** Komisioni hetoi<sup>34</sup> në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nga ku nuk rezultuan të dhëna.

**20.8** Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Komisionit ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit në datën 2.2.2009, në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë. Komisioni ka vlerësuar deri në këtë fazë të mos konsiderojë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Renault” në vitin 2008, pasi ato nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2008 e as si burim në DPV-në e vitit 2009 për krijimin e kësaj pasurie. Po ashtu, vlera e shitjes së tij është më e lartë se vlera e blerjes një vit më parë, në vitin 2007, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

**20.9** Analiza financiare iu referua të ardhurave nga pagat, nga ku subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare me të ardhura të ligjshme në shumën -625.540 (gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**20.10** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Vlera e blerjes së mjetit tip “Opel” në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë është rezultat i shitjes së mjetit tip “Renault” në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë dhe duke i shtuar shumën prej 300.000 (treqind mijë) lekë nga paga dhe të ardhurat. Fakti i mosdeklarimit cash të shumës së shitjes së automjetit tip “Renault” nuk ka të bëjë me mosdeklarim të saj, pasi një gjë e tillë është e pasqyruar në DPV-në e vitit 2009. Fakti që ky mjet u shit më shtrenjtë se u ble është i vërtetë, pasi ai që e bleu kishte pasur një të tillë më parë, por që nuk e kishte më. Çmimi i tregut është i lirë. Në hetimin financiar për këtë rast nuk janë futur veç të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes dhe ato të nënës sime, që, sido që të jenë, janë e ardhur për familjen. Ndryshe nga sa është thënë në analizën financiare, në DVP-në e vitit 2008 nga ana ime është deklaruar vlera e shitjes së automjetit tip “Renault” në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë, shumë e cila ka qenë gjendje cash në shtëpi dhe kjo shumë më pas është përdorur për të blerë automjetin tip “Opel” në vitin 2009”.*

<sup>32</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021, në dosjen e hetimit.

<sup>33</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>34</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, në dosjen e hetimit.

**20.11** Në vijim të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se subjekti rivlerësimit ndryshon deklaratimet e tij. Vlera e përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2008 jo vetëm nuk është deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie, siç pretendon subjekti, por edhe është e dyshimtë për faktin se vlera e shitjes në vitin 2008 (e ardhura e krijuar)

**20.12** Edhe nëse do të konsideroheshin në analizën financiare si burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Renault” me vlerë sa ajo e blerjes prej 300.000 (treqind mijë) lekësh, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte në pamundësi financiare për krijimin e pasurisë në shumën -287.766 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

**20.13** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë e të pamjaftueshëm në Deklaratën *Vetting* dhe se ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**20.14** Për një vlerësimin proporcional dhe objektiv, situata negative financiare do të vlerësohet në mënyrë kumulative edhe me situata të tjera financiare ndër vite deri në plotësimin e Deklaratës *Vetting*.

**21. Depozitë bankare në American Bank of Investment SA**, në shumën 5.400.000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekë. Llogaria është çelur në datën 13.5.2016. Burimi i krijimit: shuma e mësipërme prej 5.400.000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekësh vjen nga kursimet nga pagat dhe interesat e depozitave në vite, me afat ruajtjeje në Bankën e Kursimeve; depozitë me afat ruajtjeje dhe në depozitë bono thesari në Raiffeisen Bank; depozitë me afat në bono thesari në BKT; depozitë me afat në bono thesari në Bankën e Shqipërisë dhe kalimin aktualisht në depozitë ruajtjeje me afat trevjeçar, në ABI Bank.

**21.1** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021, ABI Bank informon Komisionin për të gjitha lëvizjet e llogarisë në lekë të subjektit të rivlerësimit, ku në datën 13.5.2016 është hapur llogaria e kursimit nr. \*\*\* në emër të z. Mustafa Turku, në të cilën është bërë transferimi i shumës 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë nga BKT-ja dhe depozitimi *cash* i shumës 900.000 (nëntëqind mijë) lekë nga subjekti i rivlerësimit. Në datën 13.5.2016 është çelur depozitë në shumën 5.400.000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekë, e cila përputhet me deklarinimin e subjektit në Deklaratën *Vetting*.

**21.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 31.3.2006 ka depozituar *cash* shumën 2.400.000 (dy milionë e katërqind mijë) lekë dhe kalimin në bono thesari në BKT. Kjo shumë, sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton të jetë tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në datën 3.3.2006 nga llogaria në Raiffeisen Bank.

**21.2.1** Në vitin 2007, gjendja e bonove të thesarit në BKT në emër të subjektit të rivlerësimit është 3.000.000 (tre milionë) lekë, e cila është shtuar nga interesat në vijim dhe në datën 2.5.2008 është shtuar në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, duke e transferuar këtë shumë nga llogaria nr. \*\*\*.

**21.2.2** Në vitin 2010, shuma 3.800.095 (tre milionë e tetëqind mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë e bonove të thesarit ka kaluar në llogarinë e kursimit nr. \*\*\* në BKT, në emër të Mustafa ose S. Turku.

**21.2.3** Në vitin 2011, shuma 3.000.000 (tre milionë) lekë ka kaluar në llogarinë nr. \*\*\* në emër të z. Mustafa Turku, në bono thesari pranë BKT-së dhe shuma 1.100.496 (një milion e njëqind mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në llogarinë në emër të Mustafa ose S. Turku në BKT.

**21.2.4** Në vitin 2012, shuma në llogarinë nr. \*\*\* në emër të z. Mustafa Turku në bono thesari pranë BKT-së është 4.460.000 (katër milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, e cila, së bashku me shtesat nga interesat bankarë të pasqyruar në analizën financiare, vijon të jetë deri në datën 13.5.2016, datë në të cilën transferohen te ABI Bank.

**21.3** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për krijimin e depozitave bankare me burim krijimi nga kursimet nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, si dhe interesat e depozitave ndër vite, duke marrë në konsideratë gjithashtu edhe deklarin e subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2003, ku deklaroi: *“Gjendje në vlerën 1.000.000 (një milion) në Bankën e Kursimeve Elbasan, me burim krijimi kursime nga pagat”* dhe për personin e lidhur (bashkëshorten) deklaroi: *“Depozitë bankare në vlerën 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) në Bankën e Kursimeve Elbasan, me burim krijimi pagesat nga mësimdhënia, projekte e kurse private”*.

**21.4** Analiza financiare për periudhën deri në datën 31.12.2003, ku sipas deklaramit rezultoi se janë krijuar depozitat bankare në vlerë totale 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve në bankë, duke rezultuar me një situatë negative prej -2.596.601 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një) lekësh.

**21.5** Nga informacioni i përcjellë nga Raiffeisen Bank rezultoi se në datën 21.10.2005 subjekti i rivlerësimit depoziton/transferon në llogarinë pranë kësaj banke shumë 751.592 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, nga e cila në datën 31.10.2005 shuma prej 508.872 (pesëqind e tetë mijë e tetëqind shtatëdhjetë e dy) lekësh investohet në bono thesari. Ndodhur në këto kushte, Komisioni e ka konsideruar këtë shumë të derdhur në vitin 2005, duke pritur shpjegime më të detajuara nga vetë subjekti i rivlerësimit.

**21.6** Nga dokumentacioni i përcjellë nga ABi Bank rezultoi se në datën 13.5.2016 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogari shumë 900.000 (nëntëqind mijë) lekë. Komisioni ka përgatitur analizën financiare për shtimin e depozitës bankare te ABI Bank, nga e cila subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në shumë -35.203 (tridhjetë e pesë mijë e dyqind e tre) lekë.

**21.7 Në përfundim,** Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në shumë -2.596.601 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një) lekë në krijimin fillestar të likuiditeteve në shumë 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë deri në vitin 2003, të cilat më tej kanë pësuar shtesa nga interesat, transferime nga llogari page e pakësime, duke i kaluar në likuiditete në banesë, për të cilat subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi për shtimin e tyre ndër vite në shumë 5.400.000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekë si depozitë bankare në American Bank of Investment SA.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**21.8** Në vijim të rezultateve të hetimit për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Depozita ime bankare është hapur në vitin 1982 tek Banka e Kursimeve Tiranë dhe ka vazhduar në degët e kësaj banke në Gramsh, Librazhd dhe Elbasan, si dhe ka vazhduar deri më sot me veprimet aktuale në Credins Bank. Kam kërkuar informacion nga Raiffeisen Bank për këtë fakt dhe ky informacion më mundësohet nga viti 1995 e këtej, në një kohë që për periudhën para vitit 1995 Raiffeisen Bank, e cila trashëgoi nga Banka e Kursimeve, nuk ka informacion. Kursimet e mia janë para vitit 1995 tek Banka e Kursimeve dhe të evidentuara në librezë në atë kohë. Kalimi i afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumenteve bankare nuk e mundëson dhënien e informacionit nga banka. Në këto kushte, edhe unë jam në pamundësi të dhënies së informacionit më të plotë të kërkuar nga ana juaj. Depozitat bankare nuk kanë filluar në vitin 1995, por para këtij viti dhe kanë kaluar nga njëra bankë tek tjetra, në varësi të interesit më të lartë që kishin bankat, qoftë ky interes në bono thesari, ashtu edhe në lekë. Shuma aktuale që ka përfunduar tek Credins Bank përmban në vetvete jo vetëm kursimet nga të ardhurat në vite të familjes sime, por edhe interesat bankarë të përcaktuara qartë dhe saktë në DPV nga ana ime. DPV-të çdo vit i janë nënshtruar një analize financiare nga ILDKPKI-ja dhe nuk ka pasur mospërputhje me ato çka unë kam deklaruar rregullisht. Mungesa e dokumentacionit nga bankat në vite është një nga arsytet e ekzistencës së problemeve të konstatuara nga hetimi i juaj financiar. Një analizë financiare nga ekspertë të fushës bankare,*

duke iu vënë atyre të gjithë dokumentacionin e nevojshëm bankar, do të ishte një zgjidhje e drejtë në këtë rast”.

**21.9** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e likuiditeteve në bankë, sipas deklarimeve të tij në DPV-në e vitit 2003, me burim krijimi kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Pamundësia e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për shkak të informacionit nga bankat është një situatë jokonkrete, pasi vetë subjekti ka deklaruar vlerën 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë në DPV-në e vitit 2003, e cila vjen në një rrjedhë logjike me të dhënat e disponuara nga Komisioni gjatë hetimit mbi gjendjet e tij bankare në vitet në vijim dhe ato pararendës, ndaj ai duhet të provonte mundësitë financiare për krijimin e kësaj gjendjeje të likuiditeteve në përputhje me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Nga disa të dhëna të segmentuara (periudha para vitit 2003) ka rezultuar se ai ka pasur gjendje likuiditetesh në bankë, ndër vite, konkretisht:

- a) shuma 15.580 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë dhe 23.800 (njëzet e tre mijë e tetëqind) lekë (viti 1995);
- b) shuma 71.000 (shtatëdhjetë e një mijë) lekë dhe shuma 6.832 (gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë (viti 1996);
- c) shuma 125.186 (njëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë (viti 1997);
- ç) shuma 200.165 (dyqind mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë (viti 1998);
- d) shuma 331.377 (treqind e tridhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë dhe shuma 6.832 (gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë (viti 1999);
- dh) shuma 434.969 (katërqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë (viti 2000);
- e) gjendje në bankë shumat 1.055.904 (një milion e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e katër) lekë (datë 30.1.2001) dhe shumën 1.729.249 (një milion e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e dyzet e nëntë) lekë (datë 20.12.2001) në numër të ndryshëm llogarie.

**21.10** Komisioni e ka llogaritur mundësinë për kursim të shumës 3.100.000 lekë me të ardhura në mënyrë kumulative deri në vitin 2003 (duke e përfshirë edhe vitin 2003), e cila pavarësisht nga periudhat e krijimit, konkretisht të depozitave pjesore ndër vite, paraqet mundësitë maksimale për kursim nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij (zbritur shpenzimet jetike dhe ato për krijimin e pasurive ndër vite). Nga analiza financiare e përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjorë pranë Komisionit, subjekti rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -2.596.601 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një) lekë.

**21.11** Lidhur me situatën e krijuar në vitin 2005 në depozitën në Raiffeisen Bank në datën 21.10.2005, ku subjekti i rivlerësimit depoziton/transferon në llogarinë pranë kësaj banke shumën 751.592 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, trupi gjykues në një arsyetim logjik të situatës, ka vlerësuar ta pranojë veprimin si transferim e, për pasojë, si gjendje të mbartur nga viti 2004, e cila në vetvete shkon në harmoni edhe me gjendjen e deklaruar dhe llogaritur në vitin 2003, edhe me situatën financiare të rezultuar nga analiza e përgjithshme financiare.

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje likuiditet në bankë Depozitë	3,100,000	2,909,220	3,318,900	2,400,000	3,000,000	3,470,794	3,465,653	3,800,095	4,100,496	4,460,000	4,660,000	5,070,000	5,370,000	5,400,000
Interesa bankarë			189,404	244,995	220,813	194,739	239,056	288,701	212,003	292,737	240,208	145,366	181,011	2,292
Shtesa nga transferimi i likuiditeteve nga llogaria					613,454	500,000								

**21.12 Në përfundim,** pas rillogaritjes së analizës financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor, trupi gjykues i Komisionit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme në shumën -2.631.804 (dy milionë e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e katër) lekë për krijimin e depozitës bankare në American Bank of Investment SA. Kjo situatë e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika

5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, e cila në vetvete përbën shkak për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## **22. Gjendje *cash* në banesë në shumën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë**

**22.1** Subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në DPV-të e viteve 2005, 2006, 2007, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2016.

**22.1.1** Në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 6.12.2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi se për periudhën 2003 – 2007 ka pasur pasaktësi në deklarimin e gjendjes *cash*, duke deklaruar gjendjen *cash* të mbetur deri në fund të periudhës dhe jo shtesa apo pakësime.

**22.2** Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor gjendjet e likuiditeteve *cash* në banesë janë llogaritur sipas shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në vitin 2011 (si gjendje, jo shtesa). Nga kjo analizë subjekti i rivlerësimit rezultoi në vitet 2005 dhe 2007 në pamundësi financiare për të krijuar gjendjen e likuiditeteve *cash* të deklaruara, pasi rezultoi me balancë negative në ato vite.

### **Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**22.3** Në vijim të rezultateve të hetimit për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Në këtë analizë nuk janë përmendur të ardhurat që ka përfituar bashkëshortja nga puna e bërë tek shkolla “\*\*\*” dhe shoqata “\*\*\*”. Për këto dy institucione unë kam dorëzuar dokumentacionet përkatëse që më parë dhe kërkoj që të trajtohen edhe këto si prova”*.

**22.4** Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se të ardhurat e bashkëshortes nga shkolla “\*\*\*” nuk janë të shoqëruara me ndonjë dokumentacion provues për përfitimin e tyre, si dhe pagesat e detyrimeve tatimore, vetë subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se e ka deklaruar këtë si të ardhur në DPV-të përkatëse (2006 – 2008), nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues për përfitimin e tyre, përtej deklarimeve (as gjatë hetimit dhe as në seancën dëgjimore).

**22.5** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja në shoqatën “\*\*\*” janë paraqitur vërtetime, por nuk ka një dokumentacion që provon se ato janë në formën e kërkuar nga ligji e që për këto të ardhura të jenë paguar detyrimet tatimore. Gjithashtu, këto të ardhura janë deri në vitin 2001 e nuk ndikojnë në krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2005 prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh dhe atë në vitin 2008 prej 800.000 (tetëqind mijë) lekësh.

**22.6** Në të dyja këto raste, këto të ardhura nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizën financiare të përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjor.

**22.7 Në përfundim**, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezultoi në vitet 2005 dhe 2007 me një situatë negative financiare për mbulimin e shpenzimeve përkundrejt të ardhurave, e cila sjell mungesë të aftësisë për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruara prej tij, që nga Komisioni janë marrë si gjendje (jo shtesa) në përputhje edhe me kërkesën e tij, mbështetur në deklaratimet e bëra në vitin 2011 në ILDKPKI. Kjo situatë negative është pasqyruar në analizën financiare të përgjithshme, trajtuar më poshtë në këtë vendim, dhe do të vlerësohet në tërësi edhe me situata të tjera negative financiare të rezultuara nga verifikimi dhe kontrolli i pasurive të subjektit të rivlerësimit.

#### **▪ ANALIZA E PËRGJITHSHME FINANCIARE**

**23.** Bazuar në analizimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, dokumentacionin e disponuar, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, është kryer analiza e përgjithshme financiare lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

### **23.1 Të ardhurat:**

- a) nga paga si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gramsh, Librazhd dhe Elbasan, për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2016<sup>35</sup>;
- b) nga paga e bashkëshortes si mësuese në shkollën e mesme “\*\*\*\*”, Elbasan, nga fillimi i punës, për periudhën 1.1.1993 – 30.8.2004;
- c) nga paga e bashkëshortes si pedagoge në universitetin “\*\*\*\*” Elbasan, nga fillimi i punës në këtë institucion, për periudhën 1996 – 31.12.2016;
- ç) nga paga e bashkëshortes nga universiteti “\*\*\*\*”;
- d) nga pagesa e bashkëshortes si punonjëse e angazhuar nga Ministria e Arsimit pranë AKP-së (Agjencia Kombëtare e Provimeve) Tiranë, për vitet 2013 – 2016;
- dh) nga interesat bankarë;
- e) nga paga e znj. A. T.;
- ë) nga pensionet e prindërve<sup>36</sup>.

### **23.2 Shpenzimet, ku janë përfshirë:**

- a) shpenzimet jetike në analizën e Komisionit janë llogaritur duke konsideruar praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit<sup>37</sup> me 30% të të ardhurave për periudhën 1993 – 1999 për subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe dy fëmijët, ndërsa për periudhën 2000 – 2016 sipas të dhënave të INSTAT-it të përcaktuara në shkresën e ILDKPKI-së;
- b) shpenzimet për prindërit e subjektit të rivlerësimit janë konsideruar në masën e pensioneve;
- c) shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit;
- ç) shpenzimet për mobilim, shpenzime shëndetësore të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, shpenzime shkollimi për fëmijët, qira fëmijët, transporti djali janë llogaritur sipas deklaratimeve.

**23.3** Nga analiza e përgjithshme financiare për vitet 1993 – 2003 subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare, përkatësisht në shumën: -338.229 (treqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekë në vitin 1996; -5.536 (pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në vitin 1997; -182.675 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në vitin 1998; - 947.833 (nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë në vitin 2000.

**23.4** Nga analiza e përgjithshme financiare për vitet 2003 – 2016 subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -4.957.401 (katër milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e një) lekë, përkatësisht në shumën: -2.596.601 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një) lekë në vitin 2003; -1.162.699 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë në vitin 2005; -1.168.101 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e një) lekë në vitin 2007.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi rezultatin negativ financiar.**

**23.5** Në vijim të rezultateve të hetimit për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: *“Duke marrë në konsideratë sa u parashtrua më lart, kërkoj ribërje të analizës financiare”*.

**23.6** Njësia e Shërbimit Ligjor ka bërë një vlerësim të ri të gjendjes së analizës financiare sipas shpjegimeve të dhëna më lart në këtë vendim, duke llogaritur shpenzimet e prindërve nga pensioni në masën 66%, e njëkohësisht duke i përfshirë ato si të ardhura; ka pranuar shpjegimet për investimin në pasurinë zyrë në vitin 2007, ka rishikuar shpenzimin për pasurinë garsoniere në Golem, Kavajë, si dhe ka pranuar si të ardhur shitjen e automjetit në vitin 2008, në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë dhe përfshirjen e kësaj vlere në krijimin e pasurisë automjet në vitin 2009; ka konsideruar në vitin 2004 shumën 751.592 (shtatëqind e pesëdhjetë e njëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë si gjendje në Raiffeisen Bank dhe si të transferuar në një

<sup>35</sup> Vërtetim nga ISSH Elbasan për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.1.1994 – 31.12.1994; vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për të ardhurat nga paga neto për periudhën e punësimit 1.1.1995 – 31.12.2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me detyrë prokuror.

<sup>36</sup> Të ardhurat nga pensionet e prindërve kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të tyre për periudhën 1993 – 2012, që nuk janë përfshirë në analizë.

<sup>37</sup> Vendimi nr. 15/2021, i KPA.

Ilogari tjetër në vitin 2005; ka konsideruar gjendjen e likuiditeteve *cash* sipas pretendimeve të subjektit të bëra nëpërmjet deklarimeve në ILDKPKI në vitin 2011.

**23.7 Në përfundim**, trupi gjykues, pasi vlerësoi analizën e rishikuar, vlerëson se situata negative financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit, është në shumën -4.397.122 (katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë, nga e cila rezulton -529.053 (pesëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëdhjetë e tre) lekë për krijimin e pasurisë shtëpi banimi apartament 3 + 1 + shtesa në vitin 2000; -372.019 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë për blerjen e automjetit në vitin 2000; -2.596.601 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një) lekë për krijimin e gjendjes së depozitës në vitin 2003, në shumën 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë (deklaruar në DPV-në e vitit 2003); -611.683 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë për krijimin e pasurisë garsoniere në Golem (Plazh) në vitin 2005 dhe -500.000 (pesëqind mijë) lekë për krijimin e gjendjes *cash* po atë vit; si dhe -287.766 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa” në vitin 2009. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe se ndaj tij duhet aplikuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

**24.** Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku, trupi gjykues evidentoi problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit, nga ku rezultoi se është kryer deklarim i pasaktë e i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 dhe nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**24.1** Trupi gjykues vlerëson se gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar dhe verifikimit të deklarimeve të subjektit në raport edhe me dokumentacionin e disponuar të kohës, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë të bazuara dhe në përputhje me dokumentacionin ligjor provues, përmes të cilit ai dhe personat e lidhur me të kanë fituar të drejta reale mbi pasuritë objekt i këtij hetimi administrativ. Ndër të tjera, bazuar në parimin e objektivitetit e proporcionalitetit, trupi gjykues ka vlerësuar se situata negative financiare në vlerësimin tërësor të të gjitha pasurive të krijuara dhe shpenzimeve gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës në shumën -4.397.122 (katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë është e tillë që të detyron aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**25.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse për subjektin e rivlerësimit ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**25.1** AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>38</sup> nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit Mustafa B. Turku, ku ka konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës. Ky raport është deklasifikuar plotësisht.

**25.2** Komisioni ka kryer verifikime dhe përditësim të të dhënave, nga të cilat nuk kanë rezultuar të dhëna të reja për këtë subjekt rivlerësimi.

### **Konkluzion për rubrikën e kontrollit të figurës**

**26.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit

<sup>38</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2018, në dosjen e vlerësimit të figurës.

për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**27.** Raporti i vlerësimit profesional është hartuar: mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional për periudhën objekt rivlerësimi lidhur me 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv e rastësor dhe 3 dosjet e dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit; nga të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së; si dhe të dhëna e *indicie* nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

**27.1** Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Mustafa Turku, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 1 dokument të llojit “Ankim”, 1 dokument të llojit “Konkluzione” dhe 1 dokument të llojit “Vendim pushimi”.

**27.2** Këto dokumente janë analizuar nga KLP-ja dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për verifikime të mëtejshme nga Komisioni.

**27.3** Pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura me short janë analizuar nga KLP-ja dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për verifikime të mëtejshme nga Komisioni.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE**

**28.** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Mustafa Turku janë administruar informacionet si më poshtë:

**28.1** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2020, ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku janë regjistruar 4 kallëzime penale të paraqitura nga shtetasi A. B. dhe konkretisht:

- *kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2012, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 12.11.2012;*
- *kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2015, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 21.10.2015;*
- *kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 20.9.2019;*
- *kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2020, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 13.2.2020.*

**28.2** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020, ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku është regjistruar:

- *Kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2015, i paraqitur nga shtetasi A. B., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 3.4.2015.*

**28.3** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020, ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku është regjistruar:

- *Kallëzim penal nr. \*\*\*, i vitit 2018, i paraqitur nga shtetasi A. B., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 7.1.2019.*

**28.4** Komisioni vëren se pranë sektorit të protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme ka informacion se janë regjistruar 6 ankesa për subjektin e rivlerësimit, konkretisht ankesat: nr. \*\*\*, viti 2014; nr. \*\*\*, viti 2015; nr. \*\*\*, viti 2018; nr. \*\*\*, viti 2019, të paraqitura nga shtetasi A. B., për të cilat i është kthyer përgjigje disa herë këtij shtetasi nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



**28.5** Nga hetimi<sup>39</sup> rezultoi se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2011, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me kallëzues shtetasin A. B.. Në deklaratimet e dhëna si person që tregon rrethanat e hetimit, shtetasi A. B. ka deklaruar se kallëzimi penal është bërë për falsifikimin e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. \*\*\*, datë 21.12.1991.

**28.5.1** Pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga prokurori i çështjes Mustafa Turku është arritur në konkluzionin se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, i ndodhur në arkivin e ZVRPP-së Elbasan, lëshuar në emër të kallëzuesit, nuk është i falsifikuar, ndryshe nga sa pretendohet nga kallëzuesi A. B.. Bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Penale, në datën 6.6.2012 është vendosur pushimi i procedimit penal në bazë të nenit 328, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale.

**28.5.2** Ndaj këtij vendimi shtetasi A. B. ka bërë ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku nga ana e ankuesit u parashtrua se vendimi është i padrejtë e i paligjshëm, për shkak se prokurori nuk ka kryer ekspertim grafik të shkrimeve.

**28.5.3** Nga ana e prokurorit Mustafa Turku është kërkuar rrëzimi i ankimit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë. Janë kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme dhe në përfundim është konkluduar se akti nuk është i falsifikuar.

**28.5.4** Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan gjatë shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se:

- Në kallëzimin e marrë ankuesit A. B. nuk janë përcaktuar saktësisht elementet thelbësore të faktit të paligjshëm që kallëzohet. Pa marrë të dhëna të tilla, të cilat në fund të fundit do të përbënin rrethana të faktit dhe burime të provave, nuk mund të kryhej asnjë veprim për t'i dhënë përgjigje kallëzimit.
- Në hetimin paraprak, në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, nenin 191 të këtij Kodi, janë marrë e përfshirë në fashikull kopje të pavërtetuara shkresash. Një nga llojet e provave në procesin penal janë dokumentet dhe ankuesi mund të orientohej të paraqiste dokumentet origjinale ose kopje të vërtetuara, por nuk duhet t'i merreshin e administroheshin në hetim fotokopje të pavërtetuara shkresash.
- Nga aktet e marra në hetimin paraprak, gjykata vlerëson se ka dyshim të bazuar se AMTP-ja e lëshuar për ankuesin është e falsifikuar, shkak për të cilin pretendimi i prokurorit për mungesë të qartë të faktit është i pabazuar. Në ribetim, organi procedues duhet të sekuestrojë në ZVRPP origjinalin e AMTP-së së ankuesit, të ripyese me cilësinë e dëshmitarit shtetasit R. B., B. L., S. L., si dhe anëtarë të ish-komisionit që janë gjallë, për të pohuar nëse e kanë nënshkruar këtë AMTP dhe, më tej, të kryejë ekspertim grafik për këtë AMTP. Nëse gjendet akti origjinal, që i është dhënë ankuesit nga komisioni (aktet hartoheshin në dy kopje origjinale, një nga të cilat i jepej përfituesit e tjetra dorëzohej në kadastër), të bëhet krahasimi me AMTP-në e gjendur në ZVRPP-në Elbasan me nr. \*\*\* dhe, nëse është e nevojshme, edhe ky akt t'i nënshtrohej ekspertimit grafik. Në varësi të rezultateve të hetimit mund të kryhen edhe veprime të tjera hetimore, që do t'i jepnin përgjigje pretendimit të ankuesit për falsitetin e AMTP-së së gjendur në ZVRPP, si pyetja e shtetasit Q. B. etj., e më tej do të dilej në një konkluzion bindës mbi ekzistencën e faktit.

**28.5.5** Sa më sipër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të datës 6.6.2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, duke urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan të vazhdojë hetimet për procedimin penal nr. \*\*\*.

<sup>39</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2020, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e vlerësimit profesional.

**28.5.6** Nga hetimi rezulton se në zbatim të vendimit nr. \*\*\*, datë 20.7.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka riçelur hetimet, çështja është trajtuar nga prokurori A. Xh., e cila në përfundim ka konkluduar se dokumenti AMTP me nr. \*\*\*, në emër të shtetasit A. B., pas ekspertimit teknik – grafik, ka rezultuar i falsifikuar e se plotësoheshin elementet e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Bazuar në nenin 66, shkronja “b” e Kodit Penal dhe në nenin 328/1, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal për shkak se kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale.

**28.5.7** Komisioni vlerëson se sipas dispozitës së sipërcituar pushimi i procedimit vendoset kur nga analiza e provave të marra në hetimin paraprak del qartë se fakti nuk ekziston, ndërkohë që ka rezultuar se konkluzioni i arritur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar në aktet që ndodhen në dosjen hetimore përkatëse dhe pasojë e një hetimi jo të plotë e të gjithanshëm. Konkluzioni është nxjerrë sipas një ekspertimi, rezultatet e të cilit janë bazuar në vetë aktin që pretendohet i pavërtetë (i falsifikuar). Gjatë hetimit paraprak, sipas procesverbalit “Për marrjen e dokumenteve”, datë 27.9.2011, janë administruar kopje të pavërtetuara shkresash në kundërshtim me nenin 191 të Kodit të Procedurës Penale.

**28.5.8** Sa më sipër, nga Komisioni është konstatuar se vërehen *indicie*, që e ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, dhe nenit 40 të ligjit nr. 84/2016.

**Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

**28.5.9** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “*Lidhur me çështjen që lidhet me shtetasin A. B. bashkëngjitur po ju dërgojmë akte që kanë të bëjnë me të*”, duke paraqitur dokumentin “Diskutim përfundimtar”, i cili mban datën 10.6.2015. Në vijim, subjekti arsyeton se janë kryer të gjitha veprimet hetimore dhe vendimi i pushimit bazohet në nenin 382, pika 1, shkronja “a”. ZVRPP-së Elbasan i është kërkuar praktika përkatëse meqenëse shtetasi A. B. pretendonte për falsifikim të AMTP-së në emër të tij që gjendej në ZVRPP. Nga hetimi rezultoi se AMTP-ja që ndodhej në ZVRPP-në Elbasan ishte sipas formularit 6 që shërbente si origjinë për këtë pronë. Në hetim është realizuar edhe akt ekspertimi topografik, nga ku rezultoi se AMTP-ja që gjendej në ZVRPP-në Elbasan përputhej me pronën në terren. Në këto rrethana, duke qenë se falsifikimi i AMTP-së në ZVRPP-në Elbasan nuk ekzistonte, nuk përmbahen elementet e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” sipas nenit 186/1 të Kodit Penal, duke vendosur pushimin e çështjes.

**28.5.10** Trupi gjykues, pasi ka vlerësuar tërësinë e akteve që ka disponuar gjatë hetimit në raport edhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, e gjen të gabuar vendimmarrjen e subjektit lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2011, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, sa i përket njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se për këtë procedim penal subjekti i rivlerësimit ka shmangur kryerjen e disa veprimeve hetimore të konsideruara si të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, duke evidentuar problematika të rëndësishme në ushtrimin e ndjekjes penale në çështjen në fjalë, e cila vlerësohet se ka mbetur jashtë kontrollit gjyqësor, të paktën për shkak të mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**28.5.11** Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se ndonëse gjenden elemente që tregojnë për ekzistencën e një vlerësimi me mangësi të çështjes, në kuadër të aftësive profesionale, nuk i vlerëson vetëm këto mangësi të vlefshme për të konkluduar në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, duke krijuar premisa për një vlerësim të tyre sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**29. Ankesa nr. \*\*\*, viti 2018, e shtetasit F. Z.**, i cili kërkonte zëvendësimin e prokurorit të çështjes Mustafa Turku. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, kërkesa i është dërguar për kompetencë Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës

së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në lidhje me këtë ankesë Komisioni kërkoi informacion<sup>40</sup> nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila ka përcjellë<sup>41</sup> dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë çështje.

**29.1** Sipas këtij dokumentacioni, rezulton se në datën 17.10.2018 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka marrë në shqyrtim kërkesën e shtetasit F. Z. lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Procedimi penal i mësipërm është regjistruar në vijim të kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi M. Z. në datën 23.8.2017. Në datën 20.3.2018 është bërë njoftimi për përfundimin e hetimeve dhe, më pas, çështja është dërguar për gjykim. Shtetasi F.Z. pretendon se nga gjykata nuk është pranuar kërkesa e prokurorit për gjykim të shkurtuar, prokurori nuk ka qenë objektiv në hetimin e çështjes dhe, si i tillë, nuk mund të jetë as gjatë gjykimit sepse, sipas bindjes së kërkuesit, kualifikimi i veprës penale nuk është ai që ka bërë prokurori, por duhet të ishte për veprën penale “Vrasje”.

**29.2** Në datën 17.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka informuar Drejtuesin e Prokurorisë Elbasan lidhur me kërkesën e shtetasit F. Z., kërkesë e cila në vlerësim të tij nuk ka bazë ligjore, si dhe nuk është pranuar nga gjykata. Subjekti i rivlerësimit ka refuzuar të japë pëlqimin për zëvendësimin e tij nga përfaqësimi në gjykim të çështjes.

**29.3** Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, pasi ka analizuar pretendimet e shtetasit F. Z. në raport me aktet e ndodhura në dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2017, ka konstatuar: *(i) Mungesë të legjitimitetit aktiv të këtij shtetasi në paraqitjen e kërkesës; (ii) Pretendime për veprime të tjera hetimore apo cilësimin e veprës penale në kushtet kur çështja ka kaluar në gjykim është atribut dhe kompetencë e gjykatës të vlerësojë kërkesat e palëve sipas neneve 58 dhe 332/c të Kodit të Procedurës Penale; (iii) Pretendimin se prokurori nuk është treguar objektiv gjatë hetimit dhe gjatë përfaqësimit në gjykim të çështjes, nuk gjen mbështetje në asnjë provë, por është bindje e ankuesit; (iv) Pretendimin për zëvendësimin e prokurorit në kushtet kur pretendimet e kërkuesit nuk mbështeten në aktet e shqyrtuara, në zbatim të nenit 16, të nenit 17, paragrafi i parë, shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për përjashtimin e prokurorit nuk është pranuar”.*

**29.4** Në datën 17.10.2018, Drejtuesi i Prokurorisë, në zbatim të neneve 16, 17, 24, 25, 26, 27 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës së shtetasit F. Z. për përjashtimin e prokurorit Mustafa Turku në gjykimin e çështjes penale me të pandehur shtetasin B. Z..

**29.5** Sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi të dhëna për veprime/hetime të mëtejshme e që mund të vlerësoheshin në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, dhe nenit 40 të ligjit nr. 84/2016.

**30. Ankesa nr. \*\*\* datë 21.9.2006, e shtetasit S. K. B., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm** – shtetasi S. B. ankohet për prokurorin Mustafa Turku, të cilin e akuzon për përvetësim të një shume parash në valutë të huaj (dhrahmi), që më pas prokurori i ka djegur.

**30.1** Nga hetimi<sup>42</sup> ka rezultuar se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 21.11.2006 është përcjellë materiali kallëzues nr. \*\*\* akti i shtetasit S. B., të cilit i është kthyer përgjigje edhe nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2006.

**30.2** Lidhur me këtë ankesë Komisioni nuk ka gjetur *indicie* për verifikime të tjera.

## DENONCIMET

<sup>40</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>41</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.8.2023, në dosjen e hetimit.

<sup>42</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2020; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2020.

**31.** Në lidhje me subjektin e rivlerësimit Mustafa Turku në Komision janë paraqitur 4 denoncime, të cilat u drejtohen njëherazi disa subjekteve, ndër ta edhe subjektit të rivlerësimit.

**31.1** Komisioni pasi ka vlerësuar denoncimet në raport me kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me to dhe, në përfundim të vlerësimit të tyre, trupi gjykues ka konsideruar se faktet e pretenduara në këto denoncime nuk mund të konsiderohen relevante në lidhje me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**31.2** Sipas disa *indicieve*<sup>43</sup> të marra nga burime të hapura, ka rezultuar se shtetasi V. Y, i cili po vuante dënimin për dy vrasje, nëpërmjet kërkesave drejtuar gjykatës ka kërkuar lirimin nga burgu i Peqinit, duke i njohur ditët e punës në burg, ku po vuante dënimin. Gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit, prokurori i çështjes Mustafa Turku ka shprehur dakordësinë në shkallën e parë të gjykimit, ndërsa në vijim e ka ankimuar vendimin e gjykatës.

**31.3** Për të verifikuar këto të dhëna si më sipër, Komisioni kërkoi<sup>44</sup> informacion dhe dokumentacion nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila përcolli materialin nga ku rezulton:

a. I dënuari V.Y. ka vuajtur dënimin në seksionin e sigurisë së lartë pranë I EVP-së Peqin për veprat penale “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim me paramendim dhe “Armëmbajtje pa leje”, sipas neneve 78, 25 dhe 278 të Kodit Penal, duke u dënuar me burgim të përjetshëm sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 20.4.2000, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.3.2001, të Gjykatës së Apelit Durrës. Vendimi nr. \*\*\*, datë 15.3.2001, i Gjykatës së Apelit Durrës, është rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur mospranimin e rekursit.

b. I dënuari V.Y. ka bërë kërkesë për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\* të Gjykatës së Lartë, nr. \*\*\* të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. \*\*\* të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, por me tjetër trup gjykues.

c. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2017, ka vendosur të deklarojë fajtor shtetasin V. Y., duke e dënuar atë me burgim të përjetshëm. Ky vendim është ankimuar nga i dënuari dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me ndryshimin duke e dënuar atë përfundimisht me 25 vjet burgim.

ç) Kërkuesi është dënuar gjithashtu nga Gjykata e Romës në Itali dhe është dënuar me 24 vjet burgim, vendim i cili u njoh nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.12.2016, duke i caktuar një dënim prej 23 vitesh burgim, pasi 1 vit është konsideruar i ulur nga amnistia sipas ligjit nr. 22/2014, ndërsa Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2017, ka vendosur të caktojë dënimin me 24 vjet burgim (në total për tri veprat penale).

**31.4** Procesi lidhur me ekzekutimin e vendimit për shtetasin V.Y., nga dokumentacioni ka rezultuar se është ndjekur në cilësinë e prokurorit nga subjekti i rivlerësimit z.Mustafa Turku. Konkretisht procedura e evidentuar është sa më poshtë.

**31.4.1** Vendimi nr. \*\*\*, datë 9.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka trajtuar kërkesën “Për përfitimin e uljes së dënimit”, me kërkuar V.Y. Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së të dënuarit V. Y, duke ulur dënimin në total me 360 ditë burgim nga vuajtja e dënimit të mbetur nga aplikimi i nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar. Nga vendimi nr. \*\*\*, datë 9.7.2019, konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka marrë pjesë në gjykim. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 24.7.2019. Në datën 24.9.2019, prokurori Mustafa Turku ka nxjerrë urdhrin

<sup>43</sup> <https://www.cna.al/2021/02/13/u-pendua-per-lirimin-e-dajes-se-padrinos-prokurori-ne-listen-e-zeze-te-pasurive-2>

<sup>44</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2023, në dosjen e hetimit.

për ekzekutimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**31.4.2** Vendimi nr. \*\*\*, datë 10.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkesë “Për uljen 1 vit burgim nga dënimi i mbetur si pasojë e ligjit për amnistinë”, me kërkesë V. Y. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së të dënuarit dhe përjashtimin nga vuajtja e dënimit me 1 vit burgim nga pjesa e pavuajtur e dënimit në bazë të ligjit nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie” dhe nga vendimi nr. \*\*\*, datë 10.7.2019, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë pjesë në gjykim, përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës së të dënuarit. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 25.7.2019.

**31.4.3** Vendimi nr. \*\*\*, datë 20.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkesë “Për llogaritje të ditëve të burgimit”, me kërkesë V.Y. Gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës. Nga vendimi nr. \*\*\*, datë 20.11.2019, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, i cili kërkoj të mos pranohet kërkesa e paraqitur nga i dënuari. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 5.12.2019.

**31.4.4** Vendimi nr. \*\*\*, datë 25.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkesë “Për shuarje dënimi”, me kërkesë V.Y. Gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës për shkak të heqjes dorë nga kërkuesi. Nga vendimi nr. \*\*\*, datë 25.11.2019, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, i cili nuk ishte i pranishëm gjatë dhënies së vendimit. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 6.1.2020.

**31.4.5** Vendimi nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkesë “Për njohje të ditëve të punës (konvertuar në ditë burgimi)”, me kërkesë V.Y. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, njohjen e ditëve të punës, konvertuar në 5 muaj e 16 ditë burgim: *“Urdhërohet sekretaria të njoftojë IEVP-në Peqin. Një kopje vendimi t’i dërgohet për ekzekutim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”*.

**31.4.5.1** Nga vendimi nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, i cili kërkoj gjatë gjykimit të vendoset pranimi i kërkesës si e bazuar në prova e në ligj.

**31.4.5.2** Ky vendim është ankuar në vijim nga prokurori Mustafa Turku, i cili ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në ankim prokurori Mustafa Turku ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (mungon arsyetimi).

**31.4.5.3** Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vendimi nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, ka marrë formë të prerë në datën 30.7.2020.

**31.4.6** Vendimi nr. \*\*\*, datë 25.2.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkesë “Ulje mase dënimi”, me kërkesë V. Y. – nga Gjykata është konstatuar se i dënuari V.Y., me urdhrin nr.\*\*\*prot., datë 27.12.2019, është liruar nga burgu dhe, për këtë shkak, ka vendosur deklarin si të papranueshëm të gjykimit të çështjes. Nga vendimi nr. \*\*\*, datë 25.2.2020, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka marrë pjesë në gjykim. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 11.3.2020.

**31.5** Nga vlerësimi i këtyre akteve në tërësinë e tyre, pa gjykuar themelin e çështjes apo qëndrime lidhur me këtë proces, por duke vlerësuar vetëm veprimet dhe sjelljet e organit të akuzës, në këtë rast Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në këtë proces, rezulton se për këtë çështje ajo është përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, subjekt i rivlerësimit, e se sjelljet e tij në këtë proces duken të tilla

që duhet të merren në konsideratë dhe të vlerësohen në drejtim të nënindikatorëve të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016 dhe në raport me nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale.

**31.6** Nga analizimi që Komisioni i ka bërë secilit akt, si dhe në tërësinë e tyre, duket se pjesëmarrja e prokurorit në shqyrtimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 9.7.2019, ka qenë e detyruar sipas nenit 471 të Kodit të Procedurës Penale “Mënyra e procedimit nga gjykata”. Megjithatë, prokuroria ka marrë dijeni për vendimin dhe nuk e ka ankimuar atë, duke shprehur kështu dakordësinë për këtë qëndrim/vendimmarrje e duke nxjerrë në vijim urdhrin e ekzekutimit.

**31.7** Në vendimin nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, prokurori Mustafa Turku megjithëse ka qenë dakord në procesin gjyqësor e nuk ka shprehur kundërshti, ai menjëherë e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ankim i cili nuk ka një kërkesë konkrete apo arsytim logjik e ligjor konkret e të arsyetuar. Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit ka rezultuar gjithashtu se pretendimi i ngritur nga prokurori gjatë këtij gjykimi nuk u arrit të argumentohet dhe të provohej prej tij se ku qëndrojnë paqartësitë, dyshimet apo parregullsitë e pretenduara në të dhënat e dokumentacionit, mbi të cilat është bazuar edhe vendimi i gjykatës. Ky qëndrim gjatë gjykimit, për më tepër që vetë subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë e ka qenë dakord me to, duket i paqartë.

**31.8** Sa më sipër, duket se qëndrimet e prokurorit nuk janë në koherencë. Po ashtu, nga vlerësimi në tërësi i situatës duket se ka pasur një sërë vendimesh lidhur me uljet e kohës së vuajtjes së dënimit për kërkuesin, për të cilat prokurori Mustafa Turku hera-herës nuk ka vlerësuar të marrë pjesë në to e as ankimuar e, në përfundim, qëndrimi i tij lidhur me këtë ankim duket i paqartë, konfuz e në mungesë të plotë koherence.

**31.9** Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime e dokumentacion lidhur me problematikat e konstatuara.

**31.10** Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime: *“Nga aktet në dosje për sa kohë nuk më sillte asnjë lloj dyshimi dhe aktet sillen para gjykatës nga personat përgjegjës të IEVP-së Peqin, kam mbajtur qëndrim pro që kërkesa duhet pranuar si e bazuar në prova e ligje. Duke qenë prokuror në seksionin e ekzekutimeve, brenda afatit ligjor të ankimit më vihet në dispozicion vendimi i Apelit Durrës, ku objekt gjykimi kishte qenë po ai i njohjes së ditëve të punës. Brenda afatit kam bërë ankim. Këtë parashtron dhe përmbajtja e ankimit. Fakti që ankimi bëhet nga palët pjesëmarrëse në gjykim, prokurori në rastin konkret nuk ka dijeni për progresin. Urdhri i ekzekutimit kalohet tek unë nëpërmjet titullarit të organit ose shefit të seksionit të ekzekutimit dhe jo për ankim. Jo çdo prokuror mund të bëjë ankim. Duhet të jesh prokuror i çështjes që të mund ta bësh këtë. Nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit nuk shpreh dakordësinë me vendimin. Por prokurori është i detyruar ta ekzekutojë atë edhe sikur të mos jetë prokuror i çështjes. Qëndrimet janë koherente dhe të qarta. Jam shprehur për rrëzimin e kërtimeve kur kanë qenë të pabazuara në ligj dhe prova. Nuk është marrë pjesë në çdo seancë kur nuk jam njoftuar nga gjykata. Kam ankimuar në një rast vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, edhe pse në gjykim jam shprehur dakord bazuar në fakte, për të cilat kam marrë dijeni pas dhënies së vendimit të gjykatës. Ligji më jep të drejtën e ankimit apo prishjes së vendimeve gjyqësore për prova që dalin pas dhënies së vendimeve. Përfaqësimi dhe mbrojtja e Prokurorisë dhe mbrojtja e interesave publikë nga përfaqësuesi i akuzës është bërë tërësisht në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria përfaqëson akuzën në gjykim në bazë të njoftimeve të sjella nga gjykata për prokurorin e ngarkuar me çështjen konkrete. Në të gjitha shqyrtimet ku kërkues ka qenë V. Y., unë kam përfaqësuar Prokurorinë mbi bazën e shorteut të hedhur në seksionin e ekzekutimeve, si dhe për faktin që prokuror në seksionin e ekzekutimeve dhe kërkesat e V. Y. ishin në fazën e ekzekutimit. Nuk kam munguar në seanca, por janë seanca gjyqësore që janë zhvilluar pa u njoftuar Prokuroria. Në çdo rast, qëndrimi im si përfaqësues i akuzës ka qenë i bazuar në prova të sjella në gjykim, rregullimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, sipas natyrës së kërimit. Fakti që kam lëshuar urdhrin ekzekutimi për vendimin gjyqësor, ku unë nuk*

*kam qenë përfaqësues i akuzës, është veprim në përputhje me veprimet e sektorit të ekzekutimit. Nuk ka pasur asnjëherë miratim në heshtje. Në gjykimet ku nuk jam njoftuar, nuk do të thotë që kam miratuar në heshtje, por nuk kam pasur dijeni për gjykimin. Në çdo gjykim ku kam marrë pjesë, kam dhënë mendim të shprehur qartë. Kam ushtruar ankim në rastin e Shkallës së Parë, ku kam qenë dakord për shkak të daljes së provës së re. Në qëndrimet e mia nuk ka asgjë konfuze. Institucioni i Prokurorisë është përfaqësuar në mënyrë dinjitoze dhe interesi publik është mbrojtur në mënyrën më të mirë të mundshme. Është kërkuar nga gjykata dosja nr. \*\*\*, datë 9.7.2019, me objekt “Ulje dënimi”, për të dënuarin V.Y. dhe rezultoni që aktualisht kjo dosje ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” .*

**31.11** Trupi gjykues, pasi vlerësoi informacionin që u mor nëpërmjet denoncimeve të hapura (i administruar në dosje), në raport edhe me informacionin e përcjellë nga institucionet në përgjigje të kërkesës së Komisionit, si dhe vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, konstatoi në terma të përgjithshëm disa problematika që u vlerësuan si të vlefshëm për t’u trajtuar nga Komisioni nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**31.12** Nga analiza e qëndrimeve të organit të akuzës lidhur me këtë çështje, në vetvete shumë sensitivë, rezultoni se së paku subjekti i rivlerësimit ka reflektuar një sjellje profesionale sipërfaqësore e jo në përmbushje të detyrës, duke pranuar të drejtat e kërkuarit (të dënuarit) të paktën nëpërmjet mosveprimit të organit të akuzës. Tërësia e të gjitha sjelljeve pasive të organit të akuzës ndaj kësaj çështjeje dhe në fund ankimi ndaj një vendimi gjykate, për të cilin vetë organi i akuzës është shprehur dakord gjatë gjykimin e cila, në vetvete, mbetet e papërligjshme në ndonjë rrethanë, prodhon gjithsesi një perceptim negativ të publikut, matur nga syri i një vëzhguesi të zakonshëm, në drejtim të funksionimit të organit të akuzës. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se kjo është një praktikë e ndjekur në shumë raste nga organi i akuzës, nuk mundin të justifikojnë thelbin e zgjidhjes së çështjes, e cila, e vlerësuar në tërësinë e saj, ka cenuar thelbin e veprimtarisë së organit të akuzës duke e shndërruar atë një proces abuziv.

**31.13** Në konkluzion nga aktet e analizuara më sipër, trupi gjykues vëren se nga një vëzhgim i kronologjisë së veprimeve të kryera prej subjektit, veprimeve e mosveprimeve të kryera prej tij, konstatohen sjellje sipërfaqësore, të cilat duket se, përpos të tjerave, kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes sipas kërkesave të të dënuarit, duke krijuar një perceptim publik që cenon imazhin e organit të akuzës e që bie ndesh me vlerat që duhet të përçojë integriteti i magistratit e që, për pasojë, krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe kualifikohet sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**32.** Në vlerësim të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara lidhur me denoncimet referuar edhe konkluzionit për pikën 28.5 e 28.5.11 më lartë në këtë Vendim, të cilat evidentuan ekzistencën e një vlerësimi me mangësi të çështjes, trupi gjykues çmon se veprimet e subjektit të paktën në dy raste krijojnë kushte për cënimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

**33.** Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Mustafa Turku, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58, pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 26.10.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*